



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Kuvendi

PROJEKT LIGJ

Nr. ____/2019

PËR

SHËRBIMET E PAGESAVE¹

Në mbështetje të neneve 78 e 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë

V E N D O S I:

TITULLI I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Objekti i këtij ligji është përcaktimi i kushteve dhe i rregullave për:

- a) krijimin, licencimin, organizimin, veprimtarinë dhe mbikëqyrjen e institucioneve të pagesave;
- b) transparencën e kushteve dhe kërkesat për informim për shërbimet e pagesave;
- c) të drejtat e detyrimet përkatëse të përdoruesve dhe të ofruesve të shërbimeve të pagesave lidhur me ofrimin e shërbimeve të pagesave si një veprimtari e vazhdueshme ose aktivitet tregtar.

Neni 2
Qëllimi

¹ Ky ligj përafron pjesërisht legjislacionin shqiptar me Direktivën 2015/2366 BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, të datës 25 nëntor 2015 “Për shërbimet e pagesave në tregun e brendshëm”, që ndryshon Direktivat 2002/65/EC, 2009/110/EC dhe 2013/36/EU dhe rregulloren (EU) nr.1093/2010, dhe shfuqizon Direktivën 2007/64/EC.

Qëllimi i këtij ligji është krijimi i kuadrit ligjor për shërbimet e pagesave në Republikën e Shqipërisë.

Neni 3

Fusha e zbatimit

1. Ky ligj zbatohet për shërbimet e pagesave të listuara në aneksin 1, të këtij ligji, të ofruara brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.
2. Subjekte të këtij ligji janë ofruesit e shërbimeve të pagesave, si më poshtë vijon:
 - a) Bankat dhe degët e bankave të huaja, të licencuara sipas legjislacionit në fuqi për bankat;
 - b) Institucionet e parasë elektronike, të licencuara sipas legjislacionit në fuqi për bankat;
 - c) Institucionet e pagesave, që licencohen në përputhje me këtë ligj;
 - ç) Banka e Shqipërisë, kur nuk vepron në cilësinë e saj si autoritet monetar ose autoritete të tjera publike;
 - d) Autoritetet qendrore ose vendore, kur nuk veprojnë në cilësinë e tyre si autoritete publike.
3. Banka e Shqipërisë dhe autoritetet qendrore ose vendore, kur nuk veprojnë në cilësinë e tyre si autoritete publike dhe ofrojnë shërbime pagesash, brenda kompetencave të përcaktuara në këtë ligj, nuk zbatojnë dispozitat e titujve III e IV, të këtij ligji, përveç rasteve kur përcaktohet shprehimisht në një akt nënligjor ose kontratë të veçantë lidhur me këto shërbime.

Neni 4

Përjashtimet nga fusha e zbatimit

Ky ligj nuk zbatohet për:

- a) transaksionet e pagesave në para fizike (*cash*), që paguesi i bën drejtpërdrejt përfituesit të pagesës pa ndërhyrjen e ndonjë ndërmjetësesi;
- b) transaksionet e pagesave nga paguesi te përfituesi i pagesës, nëpërmjet një agjenti tregtar të autorizuar, falë një marrëveshjeje për të negociuar apo për të mbyllur shitjen apo blerjen e mallrave ose të shërbimeve në emër vetëm të paguesit apo vetëm të përfituesit të pagesës;
- c) transportin fizik profesional të kartëmonedhave dhe monedhave, duke përfshirë grumbullimin, përpunimin e shpërndarjen e tyre;
- ç) transaksionet e pagesave që konsistojnë në grumbullimin joprofesional dhe shpërndarjen e parasë fizike, në kuadër të një aktiviteti jofitimprurës ose bamirësie;

- d) shërbimet kur paraja fizike jepet nga përfituesi i pagesës te paguesi, si pjesë e një transaksioni pagese pas një kërkesë të qartë nga ana e përdoruesit të shërbimeve të pagesave pak përpara ekzekutimit të transaksionit të pagesës, nëpërmjet një pagese për blerjen e mallrave ose të shërbimeve;
- dh) transaksionet e këmbimit valutor me para fizike (*cash*), ku fondet nuk mbahen në një llogari pagese;
- e) transaksionet e pagesave në formë letre, të tilla si: çeku, kambiali, letra premtimi ose forma të tjera pagese të ngjashme në letër, të lëshuara mbi ofruesin e shërbimeve të pagesave, me qëllim vendosjen e fondeve në dispozicion të përfituesit të pagesës;
- ë) transaksionet e pagesave të kryera brenda një sistemi pagesash ose një sistemi të shlyerjes së titujve ndërmjet agjentëve të shlyerjes, sipas përkufizimeve në legjislacionin në fuqi për sistemin e pagesave; shtëpitë e klerimit, duke përfshirë edhe rastet kur këto entitete kryejnë përlllogaritje të pozicioneve neto, të cilat bazohen në faktin që shtëpia e klerimit është blerës për çdo shitës dhe shitës për çdo blerës në një grup të specifikuar transaksionesh financiare (duke përmbyshur rolin e kundërpasive qendrore), sipas përkufizimeve në legjislacionin në fuqi për sistemin e pagesave dhe pjesëmarrësve të tjerë të sistemit e ofruesve të shërbimeve të pagesave, pa rënë ndesh me nenin 29, të këtij ligji;
- f) transaksionet e pagesave lidhur me shërbimet e titujve, duke përfshirë dividendët, të ardhurat ose shpërndarje të tjera, ripagimin ose shitjen, të kryera nga subjektet sipas shkronjës “ë”, të këtij neni, ose nga fondet e investimit, bankat, sipërmarrjet e investimeve kolektive ose shoqëritë e administrimit të aktiveve që ofrojnë shërbime investimi dhe çdo subjekt tjetër që lejohet të ketë kujdestarinë e instrumenteve financiare;
- g) shërbimet e ofruara nga ofruesit e shërbimeve teknike, të cilat mbështesin ofrimin e shërbimeve të pagesave, por nuk zotërojnë në asnjë moment fondet që do të transferohen, duke përfshirë përpunimin e ruajtjen e të dhënave, shërbimet e besimit dhe të mbrojtjes së privatësisë, autentifikimin e të dhënave dhe të subjektit, ofrimin e shërbimit të teknologjisë së informacionit (TI) e rrjetit të komunikimit, ofrimin dhe mirëmbajtjen e terminaleve e të pajisjeve që përdoren për shërbimet e pagesave me përjashtimin e shërbimit të iniciimit të pagesës, si dhe shërbimin e informimit të llogarisë;
- gj) shërbimet e bazuara në instrumentet specifike të pagesave që mund të përdoren vetëm në një mënyrë të kufizuar, që plotësojnë një nga kushtet e mëposhtme:
 - i. instrumentet që lejojnë mbajtësin të blejë mallra ose shërbime vetëm në vendndodhjet e emetuesit ose brenda një rrjeti të kufizuar të ofruesve të shërbimeve, në bazë të marrëveshjes së drejtpërdrejtë tregtare me një emetues profesional;

- ii. instrumentet, të cilat mund të përdoren vetëm për të blerë një numër shumë të kufizuar mallrash ose shërbimesh;
 - iii. instrumentet e vlefshme vetëm në territorin e Republikës së Shqipërisë, të emetuara me kërkesë të një shoqërie ose një subjekti të sektorit publik, dhe të rregulluara nga një autoritet publik qendror ose vendor për qëllime të caktuara shoqërore apo fiskale, për të blerë mallra të veçanta ose shërbime nga furnizuesit që kanë një marrëveshje tregtare me emetuesit;
- h) transaksionet e pagesave nga një ofrues i rrjeteve të komunikimeve elektronike ose shërbimet e ofruara krahas shërbimeve të komunikimeve elektronike për një pajtimtar të rrjetit ose të shërbimit:
- i. për blerje të shërbimeve digjitale dhe shërbimeve zanore, pavarësisht nga pajisja që përdoret për blerjen ose konsumin e shërbimeve digjitale dhe pasqyruar në faturën përkatëse; ose
 - ii. për të realizuar nga ose nëpërmjet një pajisjeje elektronike dhe për të pasqyruar në faturën përkatëse, në kuadër të një aktiviteti bamirësie ose për blerjen e biletave;

me kusht që kufizimet për këto transaksione pagese të përcaktohen me akt nënligjor të Bankës së Shqipërisë, për të cilat, në çdo rast, vlera e një transaksioni të vetëm pagese, parashikuar në nënndarjet “i” dhe “ii”, të kësaj shkronje, nuk e tejkalon shumën prej 7 000 (shtatë mijë) lekësh dhe:

- vlera kumulative e pagesave për një pajtimtar të vetëm nuk tejkalon vlerën prej 40 000 (dyzet mijë) lekësh në muaj; ose
 - vlera kumulative e transaksioneve të pagesave nuk tejkalon 40 000 (dyzet mijë) lekë në muaj, në rastet kur pajtimtari rimbush/parapaguan në llogarinë e tij me ofruesin e rrjetit të komunikimeve elektronike ose shërbimit të komunikimeve elektronike;
- i) transaksionet e pagesave që kryhen ndërmjet ofruesve të shërbimeve të pagesave, agjentëve ose degëve për llogari të tyre;
- j) transaksionet e pagesave ndërmjet një shoqërie mëmë dhe shoqërisë së kontrolluar prej saj ose ndërmjet shoqërive të kontrolluara të së njëjtës shoqërie mëmë, pa asnjë ndërhyrje ndërmjetësimi nga një ofrues i shërbimeve të pagesave, përveç rastit kur ndërmjetësimi bëhet nga një shoqëri që i përket të njëjtit grup;
- k) shërbimet e tërheqjes së parasë fizike nga ofruesit e shërbimeve ATM, që veprojnë në emër të një ose më shumë emetuesve të kartave, të cilët nuk janë palë në kontratën tip me një klient që tërheq para nga një llogari pagese, me kusht që këta ofrues të mos ofrojnë shërbime të tjera pagese,

të listuara në aneksin 1, të këtij ligji. Megjithatë, klientit i jepet informacioni për tarifat për tërheqjen e fondeve, sipas neneve 38, 41, 42 e 52, të këtij ligji, përpara se të kryejë tërheqjen, si dhe pas kryerjes së transaksionit të tërheqjes të parave.

Neni 5

Përkufizime

I. Në këtë ligj, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “**Agjent**”, një person fizik tregtar ose juridik, i cili vepron në emër dhe për llogari të një institucioni pagesash në ofrimin e shërbimeve të pagesave;
2. “**ATM (*Automated teller machine*)**”, një pajisje elektromekanike, e cila bën të mundur tërheqjen ose depozitimin e parasë fizike, pagesa shërbimesh, transferim fondesh ndërmjet llogarive, nxjerrje llogarie etj. ATM-të operojnë në regjim *on-line*, ku baza e të dhënave aksesohet në kohë reale, edhe në regjim *off-line*;
3. “**Autentifikim**”, procedura që i mundëson ofruesit të shërbimeve të pagesave verifikimin e identitetit të një përdoruesi të shërbimit të pagesës ose verifikimin e vlefshmërisë së një instrumenti specifik pagese, duke përfshirë edhe përdorimin e elementeve të personalizuar të sigurisë së përdoruesit;
4. “**Autentifikim i thelluar i klientit**”, një autentifikim i bazuar në përdorimin e dy ose më shumë elementeve të kategorizuara, si: njohuri (diçka që vetëm përdoruesi e di), pronësi (diçka që vetëm përdoruesi e zotëron) dhe qenësi (diçka që përdoruesi është), që janë të pavarura, në kuptimin që shkelja e njërës nuk kompromenton besueshmërinë e të tjerave dhe që është projektuar në mënyrë të tillë që të mbrojë konfidencialitetin e të dhënave që verifikohen;
5. “**Datëvalutë**”, data e përdorur nga ofruesi i shërbimeve të pagesave për llogaritjen e interesit mbi fondet e debituar nga/apo të kredituar në llogarinë e pagesës;
6. “**Debitim direkt**”, një shërbim pagese për debitimin e llogarisë së pagesës së paguesit, ku një transaksion pagese inicihet nga përfituesi i pagesës, në bazë të pëlqimit që paguesi i ka dhënë përfituesit të pagesës për ofruesin e shërbimit të pagesave të përfituesit të pagesës ose për vetë ofruesin e shërbimit të pagesave të paguesit;

7. **“Degë”**, njësia organizative e një institucioni pagese, e ndryshme nga selia qendrore, e cila nuk ka personalitet juridik e që kryen drejtpërsëdrejti disa ose të gjitha veprimtaritë për të cilat është licencuar institucioni i pagesave;
8. **“Dërgesa parash (remitanca)”**, një shërbim pagese ku fondet merren nga një pagues, pa hapur llogari pagese në emër të paguesit apo të përfituesit të pagesës, me qëllimin e vetëm transferimin e një shume përkatëse të përfituesi i pagesës ose të një ofrues tjetër shërbimesh pagese që vepron për llogari të përfituesit të pagesës dhe/ose kur këto fonde merren në emër të përfituesit të pagesës dhe vihen në dispozicion të tij;
9. **“Ditë pune”**, dita në të cilën ofruesi përkatës i shërbimit të pagesave të paguesit ose ofruesi i shërbimit të pagesave të përfituesit të pagesës, të përfshirë në ekzekutimin e një transaksioni pagese, është në punë, me qëllim ekzekutimin e një transaksioni pagese;
10. **“Emetim i instrumenteve të pagesave”**, një shërbim pagese që ofrohet nga një ofrues i shërbimit të pagesës që lidh kontratë për t’i ofruar një paguesi një instrument pagese për të iniciuar dhe procesuar transaksionet e pagesës të paguesit;
11. **“Fonde”**, kartëmonedhat e monedhat fizike, paraja në llogari ose paraja elektronike, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për bankat në Republikën e Shqipërisë;
12. **“Grup”**, një grup shoqëriish tregtare i përbërë nga shoqëria mëmë, shoqëritë e kontrolluara të saj, si dhe të gjitha subjektet mbi të cilat shoqëria mëmë apo shoqëria e kontrolluar e saj ushtron ndikim influencues apo ku zotëron pjesëmarrje;
13. **“Institucion pagese”**, personi juridik i licencuar, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, për të ofruar e kryer shërbimet e pagesave, sipas aneksit 1, pjesë e këtij ligji, në territorin e Republikës së Shqipërisë;
14. **“Instrument pagese”**, një pajisje e personalizuar dhe/ose një tërësi procedurash të dakorduara ndërmjet përdoruesit të shërbimit të pagesave dhe ofruesit të shërbimit të pagesave e të përdorura me qëllim iniciimin e një urdhërpagese;
15. **“Kapital fillestar minimal”**, shuma e kapitalit në para, e kërkuar për marrjen e licencës, për të ushtruar veprimtarinë si institucion pagese në Republikën e Shqipërisë, siç përcaktohet me akt nënligjor nga Banka e Shqipërisë;

16. **“Kapital rregulator (fondet e veta)”**, shuma e kapitalit të llogaritur për qëllime të mbikëqyrjes, ku përfshihen kategoritë e ndryshme të kapitalit e të rezervave, si dhe elemente të tjera, siç përcaktohet me akt nënligjor nga Banka e Shqipërisë;
17. **“Kod unik i identifikimit”**, një kombinim shkronjash, numrash apo simbolesh që i tregohet përdoruesit të shërbimit të pagesave nga ofruesi i shërbimeve të pagesave e që përdoret për një transaksion pagese nga përdoruesi i shërbimit të pagesave për t’u dalluar qartë nga një përdorues tjetër i shërbimit të pagesave dhe/ose nga një llogari pagese e një përdoruesi tjetër;
18. **“Konsumator”**, person fizik, i cili, në kontratat e shërbimit të pagesave që rregullohen nga ky ligj, nuk vepron për qëllimet e tij tregtare ose profesionale;
19. **“Kontratë tip”**, një marrëveshje për shërbime pagesash, e cila rregullon ekzekutimin e ardhshëm të transaksioneve të pagesave individuale dhe të njëpasnjëshme e që mund të përmbajë detyrime dhe kushte për hapjen e një llogarie pagesash. Kontrata tip hartohet të paktën në gjuhën shqipe;
20. **“Kurs këmbimi referencë”**, kursi i këmbimit që përdoret si bazë për të llogaritur çdo këmbim valutor dhe vihet në dispozicion nga ofruesi i shërbimeve të pagesave ose ofrohet nga një burim publik;
21. **“Llogari pagese”**, një llogari në emër të një ose më shumë përdoruesish të shërbimeve të pagesave, e cila përdoret për kryerjen e transaksioneve të pagesave;
22. **“Marka e pagesës”**, çdo emër, term, shenjë, simbol material ose numerik, ose kombinim i këtyre elementeve, që përcakton nën cilën skemë pagesash me kartë kanë ndodhur transaksionet e pagesave me karta;
23. **“Mënyrë komunikimi në distancë”**, një metodë që, pa praninë fizike të njëkohshme të ofruesit të shërbimit të pagesave dhe të përdoruesit të shërbimit të pagesave, mund të përdoret për lidhjen e një kontrate për shërbim pagese;
24. **“Mikrondërmarrje”**, ndërmarrja që, në momentin e lidhjes së kontratës së shërbimit të pagesave, plotëson kushtet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për ndërmarrjet e vogla e të mesme;
25. **“Mjet i qëndrueshëm komunikimi”**, çdo mjet komunikimi që i mundëson përdoruesit të shërbimeve të pagesave ruajtjen e informacionit

adresuar personalisht atij përdoruesi të shërbimeve të pagesave, në një mënyrë të tillë që mundëson përdorimin e këtij informacioni si referencë për një periudhë kohe të mjaftueshme për qëllimet e informacionit e që lejon kopjimin/riprodhimin e pandryshuar të informacionit të ruajtur;

26. **“Normë interesi referencë”**, norma e interesit që përdoret si bazë për të llogaritur çdo interes për t’u zbatuar e që vjen nga një burim në dispozicion të publikut, e cila mund të verifikohet nga të dyja palët në një kontratë shërbimi pagesash;
27. **“Ofrues i shërbimit të informimit të llogarisë”**, një ofrues shërbimi pagese që kryen shërbimet e pagesave sipas pikës 8, të aneksit 1, të këtij ligji;
28. **“Ofrues i shërbimit të iniciimit të pagesës”**, një ofrues shërbimi pagese që kryen shërbimet e pagesave sipas pikës 7, të aneksit 1, të këtij ligji;
29. **“Ofrues i shërbimeve të pagesave”**, një nga subjektet e përcaktuara në pikën 2, të nenit 3, të këtij ligji, ose një person fizik tregtar ose juridik që ofron shërbime pagesash e që përfiton nga përjashtimet sipas neneve 27 ose 28, të këtij ligji;
30. **“Ofrues i shërbimit të pagesës për shërbimin e llogarisë”**, një ofrues i shërbimit të pagesës që siguron e mirëmban një llogari pagese për paguesin;
31. **“Pagues”**, personi fizik ose juridik që është titullar i një llogarie pagesash dhe lejon kryerjen e një urdhërpagese nga kjo llogari pagese ose kur nuk ka një llogari pagese personi fizik ose juridik që jep një urdhërpagesë;
32. **“Përdorues i shërbimeve të pagesave”**, personi fizik ose juridik që përdor shërbimet e pagesave në cilësinë e paguesit, të përfituesit të pagesës ose të të dyjave;
33. **“Përfitues i pagesës”**, personi fizik apo juridik që është marrësi i parashikuar i fondeve, objekt i një transaksioni pagese;
34. **“Përmbajtje digjitale”**, produkte ose shërbime që prodhohen e furnizohen në formë digjitale, përdorimi dhe konsumi i të cilave është i kufizuar në një pajisje teknike, dhe që, në çdo rast, nuk përfshijnë përdorimin e konsumin fizik të produkteve ose shërbimeve;
35. **“Pranim i transaksioneve të pagesave”**, një shërbim pagese që ofrohet nga një ofrues shërbimi pagese që lidh kontratë me një përfitues pagese,

për të pranuar dhe procesuar transaksione pagese, që rezultojnë në transfertën e fondeve të përfituesi;

36. **“Rrjet i komunikimit elektronik”**, rrjeti i përcaktuar në legjislacionin në fuqi për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë;
37. **“Shërbim pagese”**, çdolloj veprimtarie e listuar në aneksin 1, të këtij ligji;
38. **“Shërbim i informimit të llogarisë”**, shërbimi *on-line* për të dhënë informacion të konsoliduar për një ose më shumë llogari pagesash, të mbajtura nga përdoruesi i shërbimit të pagesave me një ose disa ofrues të shërbimit të pagesave;
39. **“Shërbim i iniciimit të pagesës”**, një veprim për të filluar një transaksion pagese me kërkesën e përdoruesit të shërbimit të pagesave nga një llogari e pagesës e mbajtur në një ofrues tjetër të shërbimit të pagesave;
40. **“Shërbim i komunikimit elektronik”**, shërbimi i përcaktuar në legjislacionin për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë;
41. **“Simbol i përbashkët”**, përfshirje e një ose më shumë markave të pagesës ose aplikimeve të pagesave të së njëjtës markë pagesash në të njëjtin instrument pagese;
42. **“Sistem pagese”**, një sistem transferimi fondesh me marrëveshje formale dhe të standardizuara e me rregulla të përbashkëta për procesimin, klerimin dhe/ose shlyerjen e transaksioneve të pagesave;
43. **“Tarifë”**, çdo pagesë, detyrim apo komision, që paguhet nga klienti tek ofruesi i shërbimit të pagesave për shërbimet e lidhura me një llogari pagese;
44. **“Të dhëna sensitive të pagesës”**, të dhënat, përfshirë dhe të dhënat e personalizuara të sigurisë, të cilat mund të përdoren për të kryer një mashtrim. Për veprimtarinë e ofruesit të shërbimit të iniciimit të pagesës e ofruesit të shërbimit të informimit të llogarisë, emri i mbajtësit të llogarisë dhe numri i llogarisë nuk përbëjnë të dhëna sensitive të pagesave;
45. **“Të dhëna të personalizuara të sigurisë”**, elemente të personalizuara të mundësuar nga ofruesi i shërbimit të pagesave për përdoruesin e shërbimit të pagesave, për qëllime autentifikimi;

46. **“Transaksion pagese në distancë”**, një transaksion pagese i iniciuar nëpërmjet internetit ose një pajisjeje që mund të përdoret për komunikim në distancë;
47. **“Transaksion pagese”**, një veprim i iniciuar nga paguesi ose për llogari të tij, ose nga përfituesi i pagesës, për vendosjen, transferimin ose tërheqjen e fondeve, pavarësisht detyrimeve të tjera ndërmjet paguesit dhe përfituesit të pagesës;
48. **“Transferte krediti”**, një shërbim pagese për kreditimin e llogarisë së pagesës së një përfituesi me një transaksion pagese ose një seri transaksionesh pagese nga llogaria e pagesës së paguesit që kryhet nga ofruesi i shërbimit të pagesës, i cili mban llogarinë e pagesës së paguesit, bazuar në udhëzimin e dhënë nga paguesi;
49. **“Urdhërpagesa”**, një urdhër nga një pagues ose përfitues pagese për ofruesin e tij të shërbimit të pagesave, që kërkon ekzekutimin e një transaksioni pagese.
- II. Titujt dhe krerët në këtë ligj janë përdorur vetëm për orientim e referim dhe nuk kanë për qëllim të kushtëzojnë ose të kufizojnë interpretimin e përcaktimeve e të dispozitave të tij.
- III. Në këtë ligj, fjalët në njëjës mund të interpretohen në shumës dhe anasjelltas, kurdoherë që një gjë e tillë është e domosdoshme nga përmbajtja e dispozitës.
- IV. Termat në gjininë mashkullore nënkuptojnë dhe ato në gjininë femërore dhe anasjelltas.

TITULLI II

OFRUESIT E SHËRBIMEVE TË PAGESAVE

KREU I

INSTITUCIONET E PAGESAVE

Seksioni 1

Rregulla të përgjithshme

Neni 6

Autoriteti përgjegjës

1. Banka e Shqipërisë është autoriteti përgjegjës për dhënien e licencës për të ushtruar veprimtarinë e shërbimeve të pagesave dhe për mbikëqyrjen e institucioneve të pagesave në përputhje me këtë ligj.

2. E drejta për fillimin e ushtrimit të veprimtarisë së shërbimeve të pagesave, siç është përcaktuar në aneksin 1, të këtij ligji, lind vetëm pasi Banka e Shqipërisë ka dhënë licencën për institucionin e pagesave ose ka bërë regjistrimin për personat që përfitojnë nga përjashtimet, sipas neneve 27 e 28, të këtij ligji.
3. Banka e Shqipërisë kërkon informacion nga çdo person, nëse nga rrethana të faktit rezulton se personi kryen veprimtarinë e shërbimeve të pagesave pa licencë ose regjistrim, si dhe u kërkon institucioneve përkatëse ndalimin e veprimtarisë dhe marrjen e masave sipas legjislacionit në fuqi. Në rastin e mësipërm personi është i detyruar t'i japë Bankës së Shqipërisë të gjithë informacionin e kërkuar.

Neni 7

Aplikimi për licencë

1. Kërkesa për licencimin si institucion pagese bëhet me shkrim nga themeluesit ose nga administratori i shoqërisë, ose nga një person i autorizuar ligjërisht prej tyre dhe paraqitet pranë Bankës së Shqipërisë, e shoqëruar me:
 - a) një përshkrim të veprimtarisë që kërkohet të kryhet, duke përcaktuar shërbimet e pagesave sipas aneksit 1, të këtij ligji;
 - b) planbiznesin e propozuar, që përfshin parashikimin e gjendjes financiare të shoqërisë për 3 (tre) vitet e para të veprimtarisë, që tregon se aplikuesi është në gjendje të sigurojë sistemet, burimet dhe procedurat e duhura dhe proporcionale, për të garantuar veprimtari të qëndrueshme;
 - c) evidencën që subjekti zotëron kapitalin fillestar minimal të kërkuar;
 - ç) për subjektet që kërkojnë të ushtrojnë veprimtaritë e listuara në pikën 1 deri 6, të aneksit 1, të këtij ligji, një përshkrim të masave të marra për mbrojtjen e fondeve të përdoruesve të shërbimeve të pagesave, në përputhje me pikën 1, të nenit 12, të këtij ligji;
 - d) një përshkrim të sistemit të drejtimit dhe të kontrollit të brendshëm, duke përfshirë procedurat administrative të shoqërisë, të administrimit të rrezikut dhe procedurat kontabël, të cilat duhet të jenë proporcionale, të përshtatshme, të qëndrueshme dhe të mjaftueshme;
 - dh) një përshkrim të procedurave të vendosura për monitorimin, trajtimin dhe ndjekjen e një ngjarjeje që cenon sigurinë dhe të ankesave të klientëve që lidhen me sigurinë, duke përfshirë mekanizmin e raportimit të incidenteve, në përputhje me detyrimin për njoftim të institucionit të pagesave, sipas përcaktimeve të nenit 89, të këtij ligji;
 - e) një përshkrim të procesit të regjistrimit, monitorimit, ndjekjes dhe kufizimit të të drejtave të hyrjes në të dhënat sensitive të pagesës;

- e) një përshkrim të planit të vazhdimësisë së biznesit, duke përfshirë një identifikim të qartë të operacioneve kritike, plane efektive emergjence dhe një procedurë për rishikimin e testimin periodik të përshtatshmërisë dhe efikasitetit të këtyre planeve;
 - f) një përshkrim të parimeve dhe përcaktimeve që zbatohen për mbledhjen e të dhënave statistikore për ecurinë e veprimtarisë, transaksionet dhe mashtrimet;
 - g) një dokument të politikës së sigurisë, duke përfshirë një vlerësim të detajuar të rrezikut lidhur me shërbimet e pagesave, që ofron një përshkrim të kontrollit të sigurisë dhe masave zbutëse të marra për të mbrojtur përdoruesit e shërbimeve të pagesave ndaj rreziqeve të identifikuara, që përfshijnë edhe mashtrimin dhe përdorimin e paligjshëm të të dhënave personale e sensitive;
 - gj) një përshkrim të mekanizmave të kontrollit të brendshëm, në zbatim të kërkesave të legjislacionit në fuqi, për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;
 - h) një përshkrim të organizimit strukturor, duke përfshirë, në rastet kur është e aplikueshme, parashikimin për ushtrimin e veprimtarisë edhe nëpërmjet agentëve dhe/ose degëve dhe të kontrolleve në distancë dhe në vend, për t'u kryer të paktën çdo vit, si dhe një përshkrim të marrëveshjeve për shërbime nga të tretët, dhe një përshkrim të pjesëmarrjes së institucionit të pagesave në një sistem pagesash kombëtare ose ndërkombëtare;
 - i) identitetin e aksionarëve/ortakëve me pjesëmarrje influencuese në kapital në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, sipas përcaktimit në legjislacionin në fuqi për bankat, madhësinë e pjesëmarrjes në kapital dhe evidencë mbi reputacionin e tyre, për të siguruar një administrim të qëndrueshëm dhe të kujdesshëm të institucionit të pagesave;
 - j) identitetin e administratorit të institucionit të pagesave, sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi, dhe të personave përgjegjës për administrimin e veprimtarisë së shërbimeve të pagesave, si dhe informacion për kualifikimin, reputacionin dhe eksperiencën e tyre për të kryer shërbime pagese, siç përcaktohet në këtë ligj dhe në aktet nënligjore të Bankës së Shqipërisë;
 - k) audituesin ligjor, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për auditimin ligjor;
 - l) statutin e shoqërisë;
 - ll) adresën e zyrës qendrore.
2. Banka e Shqipërisë i kërkon subjektit që aplikon për licencim për të ofruar shërbime pagesash, sipas pikës 7, të aneksit 1, të këtij ligji, si kusht për licencimin e tij, të ketë një siguracion dëmshpërblimi profesional ose ndonjë garanci tjetër të krahueshme për të siguruar që subjekti mund të mbulojë detyrimet e tij të përcaktuara në nenet 66, 82, 83 dhe 85, të këtij ligji.

3. Banka e Shqipërisë i kërkon subjektit, që aplikon për regjistrim për të ofruar shërbime pagesash, sipas pikës 8, të aneksit 1, të këtij ligji, si kusht për regjistrimin e tij, të ketë një siguracion dëmshpërblimi profesional ose ndonjë garanci tjetër të krahasueshme kundrejt përgjegjësisë së tij ndaj ofruesit të shërbimit të llogarisë së shërbimit të pagesave ose përdoruesit të shërbimit të pagesave, që rezulton nga hyrja/aksesi i paautorizuar ose përdorimi i paautorizuar ose me qëllim mashtrimi i informacionit të llogarisë së pagesës.
4. Banka e Shqipërisë përcakton me akt nënligjor kriteret për shumën monetare minimale të siguracionit të dëmshpërblimit profesional ose të garancive të tjera të krahasueshme, referuar pikave 2 e 3, të këtij neni.
5. Banka e Shqipërisë përcakton me akt nënligjor informacionin që shoqëron kërkesën për licencim si institucion pagese, duke përfshirë kërkesat e listuara në shkronjat “a”, “b”, “c”, “d” dhe “e”, deri tek shkronja “g”, të pikës 1, të këtij neni.

Neni 8

Kontrolli i aksioneve ose kuotave

1. Çdo person fizik ose juridik, i cili ka marrë një vendim për të blerë ose për të rritur pjesëmarrjen influencuese të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, në kuptimin e legjislacionit në fuqi për bankat, në një institucion pagese, si rezultat i të cilit pjesa e kapitalit ose e të drejtave të votës të zotëruara prej tij arrijnë ose kalojnë 20 (njëzet) %, 30 (tridhjetë) % ose 50 (pesëdhjetë) % të kapitalit, ose që institucioni i pagesave bëhet shoqëri e kontrolluar prej tij, informon paraprakisht me shkrim për këtë qëllim Bankën e Shqipërisë. E njëjta gjë vlen për çdo person fizik ose juridik, i cili ka marrë një vendim për të shitur pjesëmarrjen influencuese të drejtpërdrejtë ose të tërthortë ose për ta reduktuar këtë pjesëmarrje, në mënyrë që pjesa e kapitalit ose e të drejtave të votës të zotëruara prej tij të bjerë nën 20 (njëzet) %, 30 (tridhjetë) % ose 50 (pesëdhjetë) %, ose në mënyrë të tillë që institucioni i pagesave të mos jetë më shoqëri e kontrolluar prej tij.
2. Personat fizikë ose juridikë, sipas pikës 1, të këtij neni, i paraqesin Bankës së Shqipërisë masën e synuar të pjesëmarrjes, dokumentacionin dhe informacionin përkatës, sipas përcaktimeve në aktet nënligjore të Bankës së Shqipërisë.
3. Banka e Shqipërisë, kur gjykon se influenca e ushtruar sipas pikës 2, të këtij neni, ka të ngjarë të ndikojë në përkeqësimin e administrimit të qëndrueshëm e të kujdesshëm të institucionit të pagesave, brenda tre muajve nga data e plotësimit të kërkesave të përcaktuara në këtë nen, kundërshton ndryshimin e pjesëmarrjes influencuese.

4. Nëse pjesëmarrja influencuese është realizuar pavarësisht kundërshtimit të Bankës së Shqipërisë, sipas pikës 3, të këtij neni, kjo pjesëmarrje është absolutisht e pavlefshme.

Neni 9

Kapitali fillestar minimal

Banka e Shqipërisë përcakton me akt nënligjor shumën e kapitalit fillestar minimal të kërkuar për institucionin e pagesave dhe përcakton elementet përbërëse të tij.

Neni 10

Kapitali

1. Kapitali i institucionit të pagesave nuk mund të bjerë nën shumën e kapitalit fillestar minimal të përcaktuar sipas nenit 9, të këtij ligji, ose nën shumën e kapitalit rregullator të llogaritur sipas nenit 11, të tij, cilado të jetë më e lartë.
2. Banka e Shqipërisë merr masat e nevojshme për të parandaluar përdorimin e shumëfishtë të elementeve të kualifikuara si kapital, në rastet kur institucioni i pagesave i përket të njëjtit grup me një institucion tjetër pagese, një bankë, një fond investimi ose një shoqëri administrimi aktivesh apo një shoqëri sigurimi. Kjo pikë zbatohet edhe në rastet kur institucioni i pagesave kryen edhe veprimtari të tjera të ndryshme nga ato të shërbimeve të pagesave.

Neni 11

Kapitali rregullator

1. Banka e Shqipërisë përcakton me akt nënligjor kapitalin rregullator të detyrueshëm për t'u mbajtur në çdo kohë nga institucioni i pagesave, pavarësisht kapitalit fillestar minimal. Banka e Shqipërisë përcakton përbërjen dhe metodologjinë e llogaritjes së kapitalit rregullator, bazuar në vëllimin e pagesave të kryera ose të parashikuara për t'u kryer nga institucioni i pagesave, përveç institucioneve të pagesave që ofrojnë shërbimet, sipas pikës 7 ose 8, ose të dyja njëkohësisht, sipas aneksit 1, të këtij ligji.
2. Banka e Shqipërisë, bazuar në një vlerësim të proceseve të administrimit të rrezikut, rrezikut të humbjes të të dhënave bazë dhe të mekanizmave të kontrollit të brendshëm të institucionit të pagesave, mund t'i kërkojë institucionit të pagesave që të mbajë një shumë kapitali rregullator (fonde të veta) deri në 20 (njëzet) % më të lartë se shuma e llogaritur sipas përcaktimit në aktin nënligjor të Bankës së Shqipërisë.

Neni 12

Kërkesat për mbrojtjen e fondeve

1. Institucioni i pagesave, i cili ofron shërbimet e pagesave, sipas pikave 1 deri në 6, të aneksit 1, të këtij ligji, mbron fondet e marra prej përdoruesve të shërbimeve të pagesave ose përmes ofruesve të tjerë të shërbimeve të pagesave, për kryerjen e transaksioneve të pagesave, në njërin nga mënyrat, si më poshtë vijon:
 - a) fondet e përdoruesve të shërbimit të pagesave nuk duhet të bashkohen në asnjë rast me fondet e vetë institucionit të pagesave apo të ndonjë personi fizik apo juridik, të ndryshëm nga përdoruesit e shërbimit të pagesave në emër të të cilëve janë mbajtur fondet, dhe në rastet kur ato ende mbahen nga institucioni i pagesave dhe kur nuk janë dorëzuar ende te përfituesi i pagesës ose nuk janë transferuar ende te një ofrues tjetër i shërbimit të pagesave deri në fund të ditës së punës që pason ditën kur fondet janë pranuar, ato depozitohen në një llogari të veçantë në bankë ose investohen në aktive të sigurta, me rrezik të ulët, siç përcaktohet me akt nënligjor të Bankës së Shqipërisë. Fondet e përdoruesve të shërbimeve të pagesave në asnjë rast nuk mund të bllokohen, të jenë objekt i pretendimeve të kreditorëve të tjerë të institucionit të pagesave apo t'i nënshtrohen ekzekutimit të detyrueshëm. Në rast falimentimi të institucionit të pagesave, këto fonde nuk bëjnë pjesë në masën e falimentit dhe u shpërndahen përdoruesve të shërbimeve të pagesave në mënyrë proporcionale;
 - b) fondet e përdoruesve të shërbimit të pagesave të sigurohen me policë sigurimi ose me ndonjë garanci tjetër të njëjtë me të nga një shoqëri sigurimi ose nga një bankë, e cila nuk i përket të njëjtit grup të institucionit të pagesave, për një shumë të barasvlershme me atë që do të ishte veçuar në mungesë të policës së sigurimit ose të garancisë tjetër. Polica e sigurimit ose garancia bankare është e pagueshme, në rast se institucioni i pagesave nuk është në gjendje të përmbushë detyrimet e tij financiare ndaj përdoruesve të shërbimit të pagesave.
2. Kur institucionit të pagesave i kërkohet të mbrojë fondet sipas pikës 1, të këtij neni, dhe një pjesë e këtyre fondeve do të përdoren për transaksionet e ardhshme të pagesave, ndërsa shuma e mbetur do të përdoret jo për shërbime të pagesave, ajo pjesë e fondeve që do të përdoret për transaksione të ardhshme pagesash u nënshtrohet kërkesave të pikës 1, të këtij neni. Kur kjo pjesë është e ndryshueshme apo e panjohur më parë, Banka e Shqipërisë mund të lejojë institucionet e pagesave që të zbatojnë këtë pikë mbi bazën e një pjese përfaqësuese që supozohet se do të përdoret për shërbimet e pagesave, me kusht që kjo pjesë përfaqësuese të mund të vlerësohet, në

mënyrë të arsyeshme, bazuar në të dhënat historike të pranuar nga Banka e Shqipërisë.

Neni 13

Dhënia e licencës

1. Banka e Shqipërisë kërkon që subjektet, të cilat synojnë të ofrojnë shërbime pagese, të marrin licencë si një institucion pagese para se të fillojnë ofrimin e shërbimeve të pagesave. Këtu bëjnë përjashtim subjektet e përmendura në shkronjat “a”, “b”, “ç” dhe “d”, të pikës 2, të nenit 3, të këtij ligji, dhe personat që përfitojnë nga përjashtimi sipas neneve 27 ose 28, të këtij ligji.
2. Banka e Shqipërisë i jep licencën aplikantit, nëse informacioni dhe dokumentacioni që shoqërojnë kërkesën janë në përputhje me të gjitha kërkesat e nenit 7, të këtij ligji.
3. Banka e Shqipërisë ka të drejtë të bëjë verifikime të pavarura për të provuar vërtetësinë e informacionit të ofruar nga personi që kërkon të licencohet, në përputhje me dispozitat e këtij ligji. Për këtë qëllim, Banka e Shqipërisë bashkëpunon me institucionet përkatëse publike.
4. Banka e Shqipërisë jep licencën vetëm nëse subjekti plotëson të gjitha kushtet e përcaktuara në këtë ligj dhe në aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, për drejtimin e veprimtarisë së tij të shërbimeve të pagesave, që siguron administrimin e kujdesshëm e të qëndrueshëm të tij, që përfshin:
 - a) një strukturë të qartë organizative me linja përgjegjësie të mirëpërcaktuara, transparente e të qëndrueshme;
 - b) procedura efektive për identifikimin, administrimin, monitorimin e raportimin e rreziqeve, ndaj të cilave është ose mund të jetë i ekspozuar; dhe
 - c) një sistem të përshtatshëm të kontrollit të brendshëm, duke përfshirë edhe procedurat e përshtatshme administrative dhe të kontabilitetit.

Këto rregulla, procedura dhe sisteme duhet të jenë gjithëpërfshirëse e proporcionale me natyrën, shkallën dhe kompleksitetin e shërbimeve të pagesave të ofruara nga institucioni i pagesave.

5. Kur institucioni i pagesave kërkon të ofrojë një nga shërbimet e pagesave të listuara në pikat nga 1 deri 7, të aneksit 1, të këtij ligji, dhe në të njëjtën kohë është i angazhuar në veprimtari të tjera tregtare, Banka e Shqipërisë ka të drejtë të kërkojë krijimin e një subjekti të veçantë për veprimtarinë e shërbimeve të pagesave, kur veprimtaritë e tjera të subjektit që nuk janë shërbime pagesash cenojnë apo ka të ngjarë të dëmtojnë qëndrueshmërinë

financiare të institucionit të pagesave, ose pengojnë Bankën e Shqipërisë për të monitoruar përputhshmërinë e institucionit të pagesave me të gjitha detyrimet e përcaktuara nga ky ligj. Në këto raste paraqitet një kërkesë e re për licencim.

6. Banka e Shqipërisë refuzon dhënien e licencës, nëse aksionarët ose ortakët që kanë pjesëmarrje influencuese nuk janë të përshtatshëm për të siguruar administrimin e kujdesshëm e të qëndrueshëm të institucionit të pagesave.
7. Banka e Shqipërisë jep licencën vetëm nëse krijon bindjen se ekzistenca e lidhjeve të ngushta ndërmjet institucionit të pagesave dhe personave të tjerë fizikë apo juridikë nuk pengon ushtrimin efektiv të funksioneve të saj mbikëqyrëse.

Neni 14 **Njoftimi i vendimit**

1. Banka e Shqipërisë, brenda 3 (tre) muajve nga data e pranimit të kërkesës për licencë, jep ose refuzon licencën e njofton me shkrim aplikuesin për vendimin e saj. Si datë e pranimit të kërkesës për licencë konsiderohet data kur Banka e Shqipërisë njofton aplikuesin se ka plotësuar të gjitha kërkesat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij.
2. Banka e Shqipërisë, në rast të refuzimit të dhënies së licencës, argumenton arsyet në vendimin përkatës.

Neni 15 **Shfuqizimi i licencës**

1. Banka e Shqipërisë shfuqizon licencën e dhënë kur institucioni i pagesave:
 - a) nuk ka filluar veprimtarinë brenda 12 (dymbëdhjetë) muajve nga data e marrjes së licencës apo ka ndërprerë veprimtarinë për më shumë se 6 (gjashtë) muaj, përveç rasteve kur një ndërprerje e tillë është vendosur nga Banka e Shqipërisë;
 - b) kërkon shfuqizimin e licencës;
 - c) ka marrë licencën duke dhënë informacion të rremë apo me mënyra të tjera të parregullta;
 - ç) nuk i plotëson më kushtet sipas të cilave është dhënë licenca, nuk njofton Bankën e Shqipërisë për ndryshime të rëndësishme në këtë drejtim ose ka filluar procedura e falimentimit;
 - d) përbën kërcënim për stabilitetin ose besimin e sistemit të pagesave, nëse do të vazhdonte veprimtarinë e shërbimeve të pagesave;
 - dh) konstatohet ose ka prova të besueshme se aksionarët ose administratori i institucionit të pagesave janë përfshirë në veprimtari të jashtëligjshme,

- kanë kryer mashtrime ose kanë përfituar personalisht në mënyrë të jashtëligjshme; ose
- e) kategorizohet në ndonjë nga rastet e tjera, për të cilat legjislacioni shqiptar ose i huaj parashikon heqjen e licencës apo ndalimin e kryerjes së veprimtarisë.
2. Banka e Shqipërisë argumenton çdo rast shfuqizimi të licencës dhe bën njoftimet përkatëse.
 3. Banka e Shqipërisë publikon në buletin zyrtar të saj vendimin për shfuqizimin e licencës, si dhe bën ndryshimet përkatëse në regjistrin e subjekteve të licencuara, të parashikuar në nenin 16, të këtij ligji.

Neni 16

Regjistrimi nga Banka e Shqipërisë

1. Banka e Shqipërisë mban një regjistër publik, në të cilin regjistron:
 - a) institucionet e pagesave të licencuara dhe agjentët e tyre;
 - b) personat, të cilët përfitojnë nga përjashtimet, sipas përcaktimeve në nenet 27 ose 28, të këtij ligji, dhe agjentët e tyre.
2. Regjistri specifikon shërbimet e pagesave për të cilat institucioni i pagesave, sipas shkronjës “a”, të pikës 1, të këtij neni, është licencuar, ose për të cilat personi, sipas shkronjës “b”, të pikës 1, të këtij neni, është regjistruar. Institucionet e pagesave të licencuara renditen në regjistër veçmas nga personat që përfitojnë nga përjashtimet sipas neneve 27 dhe 28, të këtij ligji. Regjistri mbahet për konsultim nga publiku, publikohet në faqen zyrtare të internetit të Bankës së Shqipërisë e përditësohet pa vonesa.
3. Banka e Shqipërisë regjistron në regjistër çdo shfuqizim licence, si dhe çdo ndryshim lidhur me përjashtimet sipas neneve 27 dhe 28, të këtij ligji.
4. Banka e Shqipërisë përcakton me akt nënligjor formën dhe përmbajtjen e regjistrit publik.

Neni 17

Detyrimi për njoftim

1. Institucioni i pagesave njofton me shkrim Bankën e Shqipërisë për faktet ose rrethanat e reja të konstatuara pas dhënies së licencës, si dhe ndryshimet që ato sjellin në dokumentacionin e paraqitur, sipas përcaktimeve të nenit 7, të këtij ligji, mbi bazën e të cilit Banka e Shqipërisë ka dhënë licencën.

2. Njoftimi sipas pikës 1, të këtij neni, bëhet menjëherë, por, në çdo rast, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas ndodhjes ose vënies në dijeni të institucionit të pagesave për faktet ose rrethanat e reja.

Neni 18

Kontabiliteti dhe auditimi ligjor

1. Institucionet e pagesave mbajnë llogaritë kontabël dhe përgatisin raportet financiare për pasqyrimin e gjendjes së tyre financiare, në mënyrë të saktë dhe në përputhje me rregullat e parimet kontabël, mbi baza individuale e të konsoliduara, sipas legjislacionit në fuqi “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.
2. Çdo institucion pagese duhet të ketë procedura administrimi, kontabiliteti dhe sisteme të mjaftueshme të kontrollit të brendshëm, mbi baza individuale e të konsoliduara, në përputhje me aktet nënligjore të Bankës së Shqipërisë.
3. Llogaritë vjetore dhe llogaritë e konsoliduara të institucioneve të pagesave auditohen nga auditues ligjorë, sipas legjislacionit në fuqi “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe të atij “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”.
4. Institucionet e pagesave që kryejnë veprimtaritë sipas pikës 1, të nenit 19, të këtij ligji, për qëllime të mbikëqyrjes, mbajnë informacion kontabël të veçantë për këto veprimtari, që duhet të jetë pjesë e raportit të audituesit ligjor.
5. Detyrimet e përcaktuara në pikat 2 deri në 5, të nenit 50, të legjislacionit në fuqi për bankat, do të zbatohen në të njëjtën mënyrë edhe për audituesit ligjorë të institucioneve të pagesave lidhur me veprimtarinë e shërbimeve të pagesave.
6. Banka e Shqipërisë përcakton me akt nënligjor formën, tipin, metodologjinë, përmbajtjen e raporteve dhe kohën e raportimit të institucioneve të pagesave në Bankën e Shqipërisë.

Neni 19

Veprimtaritë e tjera

1. Institucionet e pagesave, krahas ofrimit të shërbimeve të pagesave, mund të kryejnë edhe veprimtaritë e mëposhtme:
 - a) shërbime operacionale dhe ndihmëse, të lidhura ngushtë me shërbimet e pagesave, si ato që mundësojnë ekzekutimin e transaksioneve të

- pagesave, shërbimet e këmbimit valutor, si dhe ruajtjen e përpunimin e të dhënave;
- b) operimin e sistemeve të pagesave sipas nenit 20, të këtij ligji, dhe pa cenuar pjesëmarrjen e tij në sisteme të tjera, sipas nenit 29, të këtij ligji;
 - c) veprimtari tregtare, të ndryshme nga ato të ofrimit të shërbimit të pagesave, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
2. Kur institucionet e pagesave ofrojnë një ose më shumë shërbime pagesash, ato mund të mbajnë vetëm llogaritë e pagesave që përdoren ekskluzivisht për transaksionet e pagesave.
 3. Fondet e marra nga institucionet e pagesave prej përdoruesve të shërbimeve të pagesave, me qëllim ofrimin e shërbimeve të pagesave, nuk janë depozita apo fonde të tjera të ripagueshme dhe as para elektronike, sipas kuptimit të legjislacionit në fuqi për bankat.
 4. Institucionet e pagesave mund të japin kredi lidhur me shërbimet e pagesave, të parashikuara në pikat 4 ose 5, të aneksit 1, të këtij ligji, vetëm nëse plotësohen njëkohësisht të gjitha kushtet e mëposhtme:
 - a) kredia lehtëson e jepet ekskluzivisht me qëllim ekzekutimin e transaksionit të pagesës;
 - b) kredia e dhënë në lidhje me një pagesë duhet të shlyhet brenda një periudhe të shkurtër kohe, që në asnjë rast nuk do të tejkalojë 12 (dymbëdhjetë) muaj;
 - c) kjo kredi nuk jepet nga fondet e marra apo të mbajtura nga ofruesi i shërbimit të pagesave për qëllime të ekzekutimit të transaksioneve të pagesave, por vetëm nga fondet e ofruesit të pagesave; dhe
 - ç) shuma e përgjithshme e kredisë së dhënë nga institucioni i pagesave nuk cenon në asnjë rast kapitalin rregullator (fondet e veta) dhe përmbushjen e kërkesave mbikëqyrëse të Bankës së Shqipërisë.
 5. Institucioneve të pagesave nuk u lejohet të ushtrojnë veprimtarinë e pranimit të depozitave ose të fondeve të tjera të ripagueshme, sipas përcaktimit në legjislacionin në fuqi për bankat.
 6. Institucioni i pagesave për kreditë e dhëna konsumatorëve, sipas pikës 4, të këtij neni, zbaton kërkesat e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e konsumatorëve.
 7. Institucionet e parasë elektronike, përveç emetimit të parasë elektronike dhe ofrimit të shërbimeve të pagesave të listuara në aneksin 1, të këtij ligji, mund të kryejnë edhe një ose disa nga veprimtaritë e parashikuara në pikën 1, të këtij neni, në funksion të emetimit të parasë elektronike ose të ofrimit të

shërbimeve të pagesave. Institucionet e parasë elektronike zbatojnë kërkesat e pikave 2 deri në 6, të këtij neni.

Neni 20

Operimi i sistemeve të pagesave

1. Bankat dhe degët e bankave të huaja, institucionet e parasë elektronike dhe institucionet e pagesave kanë të drejtë të operojnë sisteme pagesash.
2. Subjektet, sipas pikës 1, të këtij neni, që operojnë sisteme pagesash sipas parimit të finalizimit të shlyerjes, licencohen, rregullohen e mbikëqyren sipas legjislacionit në fuqi për sistemin e pagesave.
3. Banka e Shqipërisë, me akt nënligjor, përcakton kushtet për operimin dhe mbikëqyrjen e sistemeve të pagesave, sipas përkufizimit të këtij ligji, të cilat nuk operojnë sipas parimit të finalizimit të shlyerjes.
4. Banka e Shqipërisë kërkon krijimin e një subjekti të veçantë për operimin e sistemeve të pagesave, kur gjykon se veprimtaritë e tjera të ofruesit të shërbimeve të pagesave që nuk janë shërbime pagesash, pengojnë apo ka të ngjarë të dëmtojnë qëndrueshmërinë financiare të ofruesit të shërbimeve të pagesave, ose pengojnë Bankën e Shqipërisë për të monitoruar përputhshmërinë e ofruesit të shërbimeve të pagesave me të gjitha detyrimet e përcaktuara nga ky ligj.

Seksioni 2

Kërkesa të tjera

Neni 21

Përdorimi i agjentëve dhe marrëveshjet me të tretët (*outsourcing*)

1. Kur institucioni i pagesave synon të ofrojë shërbimet e pagesave nëpërmjet agjentit, ai njofton Bankën e Shqipërisë dhe i paraqet informacionin e mëposhtëm:
 - a) emrin, numrin unik të identifikimit të subjektit (NUIS) dhe adresën e agjentit;
 - b) një përshkrim të mekanizmave të kontrollit të brendshëm që do të përdoren nga agjenti, në përputhje me detyrimet e legjislacionit shqiptar në fuqi, lidhur me parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit, si dhe çdo ndryshim material të tij;
 - c) identitetin e administratorit dhe të personave përgjegjës për administrimin e veprimtarisë së shërbimeve të pagesave që agjenti do të kryejë në emër dhe për llogari të institucionit të pagesave dhe për agjentët, të ndryshëm

nga ofruesit e shërbimeve të pagesave, dëshmi që janë persona të përshtatshëm siç përcaktohet në aktet nënligjore të Bankës së Shqipërisë;
ç) shërbimet e pagesave që do të kryejë agjenti.

2. Brenda 2 (dy) muajve nga marrja e informacionit sipas pikës 1, të këtij neni, Banka e Shqipërisë i komunikon institucionit të pagesave se agjenti është listuar në regjistrin e parashikuar në nenin 16, të këtij ligji. Me listimin në regjistër agjenti mund të fillojë ofrimin e shërbimeve të pagesave.
3. Para se agjenti të listohet në regjistër, Banka e Shqipërisë mund të bëjë verifikim të informacionit të paraqitur.
4. Nëse pas verifikimit të informacionit Banka e Shqipërisë gjykon që informacioni i dhënë sipas pikës 1, të këtij neni, është i pasaktë, ajo refuzon të listojë agjentin në regjistrin e parashikuar në nenin 16, të këtij ligji, dhe njofton menjëherë institucionin e pagesave.
5. Banka, vetëm në cilësinë e ofruesit të shërbimeve të pagesave, mund të veprojë me agjent, njëlloj si institucionet e pagesave, duke plotësuar të gjitha kërkesat e përcaktuara në këtë nen për agjentët.
6. Institucioni i pagesave mund të lidhë marrëveshje me të tretët për transferimin e funksioneve operationale të shërbimit të pagesave, për të cilat informon Bankën e Shqipërisë.
7. Banka e Shqipërisë ka të drejtë të refuzojë, brenda 3 (tre) muajve, marrëveshjen me të tretët për transferimin e funksioneve të rëndësishme operationale, përfshirë dhe sistemet e teknologjisë së informacionit, në rast se është e mundur të dëmtohet materialisht cilësia e kontrollit të brendshëm të institucionit të pagesave, si dhe të pengohet Banka e Shqipërisë në monitorimin e përputhshmërisë së institucionit të pagesave me të gjitha detyrimet e përcaktuara nga ky ligj dhe në aktet nënligjore në zbatim të tij.
8. Për qëllime të pikës 7, të këtij neni, një funksion operacional konsiderohet i rëndësishëm, nëse një defekt apo dështim në kryerjen e tij dëmton materialisht përputhshmërinë e vazhdueshme të institucionit të pagesave me kërkesat e licencimit të tij sipas këtij titulli ose me detyrimet e tjera sipas këtij ligji, ose dëmton gjendjen e tij financiare, qëndrueshmërinë ose vazhdimësinë e shërbimeve të tij të pagesave.
9. Institucioni i pagesave, kur lidh marrëveshje me të tretët për transferimin e funksioneve të rëndësishme operationale, nuk mund:
 - a) të transferojë veprimtaritë për të cilat është licencuar;

- b) të transferojë përgjegjësitë e administratorit;
 - c) të ndryshojë marrëdhëniet dhe detyrimet e institucionit të pagesave ndaj përdoruesve të shërbimeve të pagesave sipas këtij ligji;
 - ç) të ndryshojë kushtet që duhet të përmbushë institucioni i pagesave, në mënyrë që të jetë i licencuar e të mbetet i licencuar në përputhje me këtë ligj.
10. Institucioni i pagesave siguron që agjentët e tij të informojnë përdoruesit e shërbimeve të pagesave se për cilin institucion veprojnë.
11. Institucionet e pagesave njoftojnë menjëherë Bankën e Shqipërisë për çdo ndryshim lidhur me marrëveshjet me të tretët e me agjentët, sipas kërkesave të këtij neni.

Neni 22

Përgjegjësia

1. Institucionet e pagesave, kur lidhin me të tretët marrëveshje për transferimin e funksioneve operationale, marrin masat e nevojshme për të siguruar përmbushjen e kërkesave të këtij ligji.
2. Institucionet e pagesave janë plotësisht përgjegjëse për çdo veprim të punonjësve të tyre, të agjentëve, të degëve e të subjekteve, të cilave u janë deleguar veprimtaritë e tyre.
3. Bankat janë plotësisht përgjegjëse për çdo veprim të agjentëve, të cilëve u kanë deleguar veprimtarinë e shërbimeve të pagesave.

Neni 23

Ruajtja e të dhënave

Institucionet e pagesave ruajnë të gjitha të dhënat e nevojshme, për qëllime të këtij titulli, për një periudhë pesëvjeçare.

Seksioni 3

Procesi i mbikëqyrjes

Neni 24

Autoriteti mbikëqyrës

Banka e Shqipërisë është autoriteti që mbikëqyr institucionet e pagesave, sipas

dispozitave të këtij ligji dhe akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij.

Neni 25

Mbikëqyrja

1. Banka e Shqipërisë, për të monitoruar përputhshmërinë e vazhdueshme me kërkesat e këtij ligji, ushtron funksionin e saj mbikëqyrës në mënyrë proporcionale, të përshtatshme dhe në përputhje me profilin e rrezikut ndaj të cilit ekspozohen institucionet e pagesave.
2. Banka e Shqipërisë, për të siguruar përputhshmërinë me kërkesat e këtij ligji, ka të drejtë:
 - a) t'i kërkojë institucionit të pagesave çdo informacion të nevojshëm, duke specifikuar qëllimin e kërkesës dhe afatin kohor në të cilin informacioni duhet të sigurohet;
 - b) të kryejë inspektime në vend në institucionin e pagesave, në çdo agjent apo degë që ofron shërbime pagese në emër të tij ose në çdo subjekt me të cilin ka lidhur marrëveshje për transferimin e funksioneve operationale;
 - c) të nxjerrë rekomandime, udhëzime, të vendosë sanksione administrative, deri në pezullimin e një ose disa veprimtarive;
 - ç) të shfuqizojë licencën sipas nenit 15, të këtij ligji.
3. Banka e Shqipërisë, në rast se konstaton shkelje të kërkesave të këtij ligji ose të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, urdhëron institucionin e pagesave ose personat, të cilët efektivisht kontrollojnë veprimtarinë e institucionit të pagesave, të ndërpresin veprimet në kundërvajtje, si dhe të ndreqin shkeljet e konstatuara.
4. Banka e Shqipërisë, në rast se vlerëson se ushtrimi i aktiviteteve të tjera të ndryshme nga veprimtaria e shërbimit të pagesave dëmton ose mund të dëmtojë qëndrueshmërinë financiare të institucionit të pagesave, në përputhje me pikën 2, të këtij neni, i kërkon institucionit të pagesave kapital të mjaftueshëm, krahas kërkesave sipas neneve 9, 10 e 11, të këtij ligji.

Neni 26

Sekreti profesional

1. Personat që punojnë ose kanë punuar për Bankën e Shqipërisë, si dhe ekspertët që veprojnë për llogari të Bankës së Shqipërisë, kanë detyrimin e ruajtjes së sekretit profesional, përveç rasteve të parashikuara nga legjislacioni penal.

2. Në shkëmbimin e informacionit, në rast të bashkëpunimit ndërinstitucional, detyrimi për ruajtjen e sekretit profesional zbatohet rreptësisht për të siguruar mbrojtjen e të dhënave personale dhe tregtare.
3. Banka e Shqipërisë mund të shkëmbejë informacion me autoritetet mbikëqyrëse të huaja, bankat qendrore të huaja dhe institucionet e pagesave, duke respektuar parimin e reciprocitetit, të miratimit paraprak dhe me kusht që të ruhet konfidencialiteti e të garantohet niveli i mbrojtjes të të dhënave personale.

Seksioni 4 **Përfshirja**

Neni 27 **Kushtet**

1. Banka e Shqipërisë ka të drejtë të përfshijë personat fizikë ose juridikë që ofrojnë ose kërkojnë të ofrojnë shërbimet e pagesave të listuara në pikat 1 deri në 6, të aneksit 1, të këtij ligji, nga zbatimi i të gjitha ose të një pjese të kërkesave dhe kushteve të përcaktuara në seksionet 1, 2 e 3, të kreut I, të titullit II, të këtij ligji, me përfshirje të neneve 16, 24, 26 e 97, të këtij ligji, kur:
 - a) mesatarja mujore e shumës totale të transaksioneve të pagesave nuk tejkalon limitin e vendosur nga Banka e Shqipërisë me akt nënligjor. Kjo zbatohet:
 - i. për personat që kryejnë shërbime pagesash mbështetur në transaksionet e kryera gjatë 12 (dymbëdhjetë) muajve paraardhës, duke përfshirë edhe agjentët për të cilët merr përgjegjësi të plotë;
 - ii. për subjektet që paraqesin kërkesë, vlerësohet bazuar në shumën totale të transaksioneve të pagesave të parashikuara në planin e biznesit, përveç rastit kur nga Banka e Shqipërisë kërkohet një përshtatje në këtë plan biznesi; dhe
 - b) personat përgjegjës për administrimin apo ushtrimin e veprimtarisë të mos jenë dënuar për vepra penale.
2. Personat sipas pikës 1, të këtij neni, konsiderohen si institucione pagesash.
3. Personat sipas pikës 1, të këtij neni, njoftojnë Bankën e Shqipërisë për çdo ndryshim të situatës së tyre që lidhet me kushtet e specifikuar në atë pikë. Këta persona, në rast se nuk përmbushin më kushtet e përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, i paraqesin Bankës së Shqipërisë kërkesën për licencim

brenda 30 (tridhjetë) ditëve, në përputhje me procedurën e përcaktuar në nenin 13, të këtij ligji.

Neni 28

Ofruesit e shërbimit të informimit të llogarisë

1. Personat fizikë ose juridikë, që ofrojnë vetëm shërbimin e pagesave të parashikuara në pikën 8, të aneksit 1, të këtij ligji, përjashtohen nga zbatimi i kërkesave dhe kushteve të parashikuara në seksionet 1 dhe 2, të këtij kreu, me përjashtim të shkronjave “a”, “b”, “d” deri në “ë”, “g”, “h”, “j”, “l” dhe “ll”, të pikës 1, dhe të pikës 3, të nenit 7, si dhe të nenit 16, të këtij ligji. Seksioni 3 zbatohet me përjashtim të pikës 4, të nenit 25, të këtij ligji.
2. Personat sipas pikës 1, të këtij neni, konsiderohen si institucione pagese, përveç titujve III e IV, që nuk zbatohen për to, me përjashtim të neneve 34, 38 e 45, të këtij ligji, kur është e aplikueshme, dhe të neneve 60, 62, 88 deri në 91, të këtij ligji.

KREU II

DISPOZITA TË PËRBASHKËTA

Neni 29

Pjesëmarrja në sistemet e pagesave

1. Personat juridikë, ofrues të shërbimeve të pagesave që janë të licencuar ose të regjistruar nga Banka e Shqipërisë kanë të drejtë të marrin pjesë në sisteme pagesash.

Sistemet e pagesave për ofruesit e shërbimeve të pagesave sipas kësaj pike vendosin rregulla pjesëmarrjeje objektive, jodiskriminuese e proporcionale. Këto rregulla duhet të jenë të tilla që të mos pengojnë pjesëmarrjen e tyre në sistem dhe nga ana tjetër të mbrojnë sistemin kundrejt rrezikut të shlyerjes, rrezikut operacional dhe rrezikut të biznesit, si dhe të mbrojnë stabilitetin financiar dhe operacional të sistemit të pagesave.

Sistemet e pagesave për ofruesit e shërbimeve të pagesave, për përdoruesit e shërbimeve të pagesave ose për sisteme të tjera pagesash nuk vendosin:

- a) rregulla kufizuese për pjesëmarrje efektive në sistemet e tjera të pagesave;
- b) rregulla që diskriminojnë ndërmjet ofruesve të licencuar të shërbimeve të pagesave ose ndërmjet ofruesve të regjistruar të shërbimeve të pagesave lidhur me të drejtat e detyrimet e pjesëmarrësve;

c) kufizime në bazë të natyrës së pjesëmarrësit.

2. Pika 1, e këtij neni, nuk zbatohet për:

- a) sistemet e pagesave të rregulluara me legjislacionin në fuqi për sistemin e pagesave, të cilat funksionojnë sipas parimit të finalizimit të shlyerjes;
- b) sistemet e pagesave që përbëhen vetëm nga ofrues të shërbimeve të pagesave që i përkasin një grupi.

3. Pjesëmarrësi në një sistem pagesash, që funksionon sipas parimit të finalizimit të shlyerjes, duhet të lejojë një ofrues të shërbimit të pagesave të licencuar ose të regjistruar që nuk është pjesëmarrës në këtë sistem, të kalojë urdhërpagesa nëpërmjet këtij sistemi. I njëjti pjesëmarrës, kur i kërkohet, duhet t'i japë të njëjtën mundësi, në mënyrë objektive, proporcionale dhe jodiskriminuese ofruesve të tjerë të shërbimeve të pagesave, të licencuar ose të regjistruar, sipas parashikimeve të pikave 1 e 2, të këtij neni. Në rast se pjesëmarrësi refuzon, ai i paraqet ofruesit të shërbimit të pagesave arsyet e plota të refuzimit.

Neni 30

Aksesi në llogaritë e mbajtura në një bankë

- 1. Institucionet e pagesave dhe institucionet e parasë elektronike kanë të drejtë të kenë akses në shërbimet e llogarisë së pagesës në banka, në mënyrë objektive, jodiskriminuese e proporcionale. Aksesit duhet të jetë i tillë që t'i lejojë këto institucione të ofrojnë shërbime pagesash, pa pengesa dhe në mënyrë efikase.
- 2. Bankat njoftojnë Bankën e Shqipërisë për çdo rast refuzimi sipas pikës 1, të këtij neni, të shoqëruar me arsyet përkatëse.

Neni 31

Ndalimi i personave të ndryshëm nga ofruesit e shërbimeve të pagesave nga ofrimi i shërbimeve të pagesave dhe detyrimi për njoftim

- 1. Personat fizikë ose juridikë që nuk janë ofrues të shërbimeve të pagesave ose nuk janë të përjashtuar shprehimisht sipas nenit 4, të këtij ligji, e kanë të ndaluar të ofrojnë shërbimet e pagesave.
- 2. Ofruesit e shërbimeve që kryejnë njërën nga veprimtaritë sipas nënndarjeve “i” dhe “ii”, të shkronjës “gj”, të nenit 4, të këtij ligji, ose të

dyja njëkohësisht, dhe kur vlera totale e transaksioneve të pagesave të kryera brenda 12 (dymbëdhjetë) muajve paraardhës tejkalon shumë prej 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) lekësh, njoftojnë Bankën e Shqipërisë, duke specifikuar shërbimet e ofruara dhe duke evidentuar përjashtimin e referuar në nënndarjet “i” dhe “ii”, të shkronjës “gj”, të nenit 4, të këtij ligji, sipas të cilit konsiderohet të kryhet veprimtaria. Mbi bazën e këtij njoftimi, Banka e Shqipërisë merr një vendim të mirëargumentuar për vazhdimësinë ose jo të përjashtimit dhe informon ofruesin e shërbimeve.

3. Ofruesit e shërbimeve që kryejnë një veprimtari sipas shkronjës “h”, të nenit 4, të këtij ligji, njoftojnë Bankën e Shqipërisë dhe i paraqesin opinionin vjetor të audituesit ligjor, që dëshmon se veprimtaria përputhet me kufijtë e përcaktuar në shkronjën “h”, të nenit 4, të këtij ligji.
4. Banka e Shqipërisë publikon në regjistrin e parashikuar në nenin 16, të këtij ligji, personin dhe përshkrimin e veprimtarisë së njoftuar sipas pikave 2 e 3, të këtij neni.

TITULLI III

TRANSPARENCA E KUSHTEVE DHE KËRKESAT PËR INFORMIM PËR SHËRBIMET E PAGESAVE

KREU I

RREGULLA TË PËRGJITHSHME

Neni 32

Fusha e zbatimit

1. Dispozitat e këtij titulli zbatohen për transaksionet individuale të pagesave, kontratat tip dhe transaksionet e pagesave që rregullohen prej tyre. Palët mund të bien dakord që ky kre të mos zbatohet, tërësisht ose pjesërisht, kur përdoruesi i shërbimeve të pagesave nuk është një konsumator.
2. Në zbatim të dispozitave të këtij titulli, mikrondërmarrjet trajtohen në të njëjtën mënyrë si konsumatorët.
3. Dispozitat e këtij titulli, me përjashtim të shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 38; të nënndarjes “v”, të shkronjës “b”, të nenit 45, dhe të shkronjës “a”, të pikës 1, të nenit 49, të këtij ligji, zbatohen për pagesat kombëtare në monedhë të huaj, si në rastin kur pagesa kryhet ndërmjet dy ofruesve të

shërbimeve të pagesave, atë të paguesit dhe atë të përfituesit, ashtu dhe kur ofruesi i shërbimit të pagesave të paguesit dhe përfituesit është i njëjtë, për atë pjesë të pagesës që kryhet brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

4. Dispozitat e këtij titulli, me përjashtim të shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 38; të nënndarjes “v”, të shkronjës “b”, të nenit 45; të nënpikës “vii”, të shkronjës “d”, të nenit 45; dhe të shkronjës “a”, të pikës 1, të nenit 49, zbatohen edhe për pagesat ndërkufitare, për sa i përket pjesës së transaksionit të pagesës të kryer brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.
5. Dispozitat e këtij ligji nuk cenojnë zbatimin e legjislacionit shqiptar lidhur me kushtet e dhënies së kredive konsumatore, të cilat nuk janë të rregulluara nga ky ligj.

Neni 33

Tarifat për dhënie informacioni

1. Ofruesi i shërbimeve të pagesave nuk tarifon përdoruesin e shërbimeve të pagesave për dhënien e informacionit, sipas këtij titulli.
2. Ofruesi dhe përdoruesi i shërbimeve të pagesave mund të bien dakord për tarifat për dhënien e informacionit shtesë apo për informim më të shpeshtë, ose për transmetimin e informacionit me anë të mjeteve të tjera të komunikimit, të ndryshme nga ato të specifikuara në kontratën tip, sipas kërkesës së përdoruesit të shërbimeve të pagesave.
3. Në rastet kur ofruesi i shërbimeve të pagesave vendos tarifa për dhënien e informacionit në përputhje me pikën 2, të këtij neni, këto tarifa duhet të jenë të arsyeshme dhe të mbështetura në kostot reale të ofruesit të shërbimeve të pagesave.

Neni 34

Barra e provës për kërkesat për informim

Ofruesi i shërbimeve të pagesave ka barrën e provës për të vërtetuar se ka vepruar në përputhje me kërkesat për informim të përcaktuara në këtë titull.

Neni 35

Përjashtimi nga kërkesat për informim për instrumentet e pagesave me vlerë të vogël dhe për paranë elektronike

1. Në rastet e instrumenteve të pagesave, të cilat, sipas kontratës përkatëse tip, nuk tejkalojnë limitet e përcaktuara në aktet nënligjore të Bankës së Shqipërisë, që, në çdo rast, nuk tejkalojnë shumën prej 4 000

(katër mijë) lekësh për një transaksion individual pagese, ose kanë një limit shpenzimi në shumën 20 000 (njëzet mijë) lekë, ose ruajnë vlera që nuk tejkalojnë shumën prej 20 000 (njëzet mijë) lekësh për pagesat me vlerë të vogël ose për paranë elektronike, në çdo kohë:

- a) ofruesi i shërbimeve të pagesave, me përjashtim të neneve 44, 45 e 49, të këtij ligji, i jep paguesit vetëm informacionin për karakteristikat kryesore të shërbimeve të pagesave. Ky informacion përfshin mënyrën e përdorimit të instrumentit të pagesave, detyrimet, tarifat dhe informacione të tjera të nevojshme për vendimmarrjen e paguesit, si edhe mënyrën lehtësisht të aksesueshme të çdo informacioni dhe kushtet e tjera të përcaktuara në nenin 45, të këtij ligji;
 - b) palët mund të bien dakord që, në përjashtim nga neni 47, i këtij ligji, ofruesi i shërbimeve të pagesave të mos bëjë propozime për ndryshime në kushtet e kontratës tip, në të njëjtën mënyrë, siç parashikohet në pikën 1, të nenit 44, të këtij ligji;
 - c) palët mund të bien dakord që, në përjashtim nga nenet 50 dhe 51, pas ekzekutimit të një transaksioni pagese:
 - i. ofruesi i shërbimeve të pagesave jep ose vendos në dispozicion vetëm një referencë, që i mundëson përdoruesit të shërbimeve të pagesave identifikimin dhe shumën e transaksionit të pagesës, çdo tarifë dhe/ose, në rastin e disa transaksioneve pagese të të njëjtit lloj të kryera tek i njëjti përfitues pagese, informacionin për shumën totale dhe tarifat për ato transaksione pagese;
 - ii. ofruesi i shërbimeve të pagesave nuk është i detyruar të japë apo të vendosë në dispozicion informacionin e përmendur në nënndarjen “i”, të kësaj shkronje, nëse instrumenti i pagesës është përdorur në mënyrë anonime ose nëse ofruesi i shërbimeve të pagesave teknikisht nuk është në gjendje të sigurojë këtë informacion. Megjithatë, ofruesi i shërbimeve të pagesave duhet t’i japë paguesit një mundësi për të verifikuar shumën e fondeve të ruajtura.
2. Banka e Shqipërisë, me akt nënligjor, mund të ulë ose të dyfishojë limitet sipas pikës 1, të këtij neni. Për instrumentet e pagesave të parapaguara, limiti mund të rritet deri në një nivel të përcaktuar me akt nënligjor të Bankës së Shqipërisë.

KREU II

TRANSAKSIONET INDIVIDUALE TË PAGESËS

Neni 36

Fusha e zbatimit

1. Ky kre zbatohet për transaksionet individuale të pagesës që nuk mbulohen nga një kontratë tip.
2. Kur një urdhërpagesë për një transaksion individual pagese transmetohet me anë të një instrumenti pagese bazuar në një kontratë tip, ofruesi i shërbimeve të pagesave nuk është i detyruar të japë ose të bëjë të disponueshëm informacionin e dhënë tashmë për përdoruesin e shërbimeve të pagesave, në bazë të një kontrate tip me një ofrues tjetër të shërbimeve të pagesave apo që do t'i jepet atij sipas asaj kontrate tip.

Neni 37

Informacioni paraprak i përgjithshëm

1. Ofruesi i shërbimeve të pagesave vë në dispozicion të përdoruesit të shërbimeve të pagesës, para nënshkrimit të një kontrate shërbimi për një pagesë individuale apo ndonjë ofertë, informacionin dhe kushtet e përcaktuara në nenin 38, të këtij ligji, në një mënyrë lehtësisht të aksesueshme lidhur me shërbimet e veta. Me kërkesën e përdoruesit të shërbimeve të pagesave, ofruesi i shërbimeve të pagesave duhet të japë informacionin dhe kushtet e shërbimit, të shkruara në letër ose në një formë tjetër të qëndrueshme komunikimi. Këto informacione dhe kushte duhet të shprehen me fjalë lehtësisht të kuptueshme dhe në një formë të qartë, të paktën në gjuhën shqipe.
2. Nëse kontrata e shërbimit për një pagesë individuale është lidhur me kërkesën e përdoruesit të shërbimeve të pagesave, duke përdorur një mjet të komunikimit në distancë, që nuk i mundëson ofruesit të shërbimeve të pagesave pajtueshmërinë me pikën 1, të këtij neni, ofruesi i shërbimeve të pagesave duhet të përmbushë detyrimet e tij sipas asaj pike, menjëherë pas ekzekutimit të transaksionit të pagesës.
3. Detyrimet që rrjedhin nga pika 1, e këtij neni, mund të përmbushen edhe duke dhënë një kopje të projektkontratës së shërbimit të pagesës individuale apo një kopje të modelit të urdhërpagesës, duke përfshirë informacionin e kushtet e përcaktuara në nenin 38, të këtij ligji.

Neni 38

Informacioni dhe kushtet

1. Ofruesi i shërbimeve të pagesave i jep ose i vë në dispozicion përdoruesit të shërbimeve të pagesave informacionin e kushtet e mëposhtme:
 - a) një specifikim të informacionit ose identifikuesin unik që përdoruesi i shërbimeve të pagesave duhet të japë me qëllim iniciimin ose ekzekutimin e saktë të urdhrit të pagesës;

- b) kohën maksimale të ekzekutimit, që duhet për kryerjen e shërbimit të pagesës;
 - c) të gjitha tarifat që përdoruesi i shërbimeve të pagesave duhet t'i paguajë ofruesit të shërbimeve të pagesave dhe, kur është e zbatueshme, një ndarje në zëra të këtyre tarifave;
 - ç) kur është e zbatueshme, normën aktuale apo referencë të kursit të këmbimit për transaksionin e pagesës.
2. Ofruesit e shërbimit të iniciimit të pagesës, përpara se të iniciojnë një pagesë, i japin ose i mundësojnë paguesit informacion të qartë e të kuptueshëm për:
- a) emrin e ofruesit të shërbimit të iniciimit të pagesës, adresën e selisë qendrore dhe, kur është e zbatueshme, adresën e agjentit të tij ose të degës ku shërbimi i pagesës ofrohet, si dhe çdo informacion lidhur me kontaktin, duke përfshirë adresën elektronike për komunikimin me ofruesit e shërbimit të iniciimit të pagesës; dhe
 - b) të dhënat e Bankës së Shqipërisë.
3. Kur është e zbatueshme, çdo informacion tjetër përkatës dhe kushtet e përcaktuara në nenin 45, të këtij ligji, vihen në dispozicion të përdoruesit të shërbimeve të pagesave në një mënyrë lehtësisht të aksesueshme.

Neni 39

Informacionet për paguesin dhe përfituesin pas iniciimit të urdhërpagesës

Krahas informacioneve dhe kushteve të parashikuara në nenin 38, të këtij ligji, kur një urdhërpagesë iniciohet nëpërmjet një ofruesi të shërbimit të iniciimit të pagesës, ky i fundit, menjëherë pasi ka iniciuar urdhërpagesën, i jep ose i mundëson paguesit dhe, kur është e zbatueshme, edhe përfituesit, të dhënat e mëposhtme:

- a) konfirmimin e iniciimit të suksesshëm të urdhërpagesës nga ofruesi i shërbimit të pagesës për shërbimin e llogarisë së paguesit;
- b) referencën për t'i mundësuar paguesit dhe përfituesit të identifikojë transaksionin e pagesës dhe, kur është e mundshme, për t'i lejuar përfituesit të identifikojë paguesin, si edhe çdo informacion të dhënë gjatë transaksionit të pagesës;
- c) vlerën e transaksionit të pagesës;
- ç) kur është e zbatueshme, tarifën e çdo shpenzimi që i paguhet ofruesit të shërbimit të iniciimit të pagesës për transaksionin dhe, kur është e zbatueshme, një ndarje në zëra të shumave të këtyre tarifave.

Neni 40

Informacioni për ofruesin e shërbimit të pagesës për shërbimin e llogarisë së paguesit, në rastin e iniciimit të shërbimit të pagesës

Në rastin kur një urdhërpagesë inicohet nëpërmjet një ofruesi të shërbimit të iniciimit të pagesës, ai vendos në dispozicion të ofruesit të shërbimit të pagesës për shërbimin e llogarisë së paguesit referencën e transaksionit të pagesës.

Neni 41

Informacion për paguesin pas marrjes së urdhërpagesës

Ofruesi i shërbimit të pagesës së paguesit, menjëherë pas marrjes së urdhërpagesës, jep ose vendos në dispozicion të paguesit, në të njëjtën mënyrë siç parashikohet në pikën 1, të nenit 37, të këtij ligji, të gjitha të dhënat e mëposhtme, lidhur me shërbimet e veta:

- a) referencën, që i mundëson paguesit të identifikojë transaksionin e pagesës dhe, kur është e mundshme, informacion lidhur me përfituesin e pagesës;
- b) shumën e transaksionit të pagesës në monedhën që është përdorur në urdhërpagesë;
- c) shumën e tarifave që duhen paguar nga paguesi për transaksionin e pagesës dhe, aty ku është e zbatueshme, një ndarje në zëra të shumave të këtyre tarifave;
- ç) kur është e zbatueshme, kursin e këmbimit të përdorur në transaksionin e pagesës nga ofruesi i shërbimeve të pagesave të paguesit apo një referencë kur kursi është i ndryshëm nga kursi i dhënë, sipas shkronjës “ç”, të pikës 1, të nenit 38, dhe shumën e transaksionit të pagesës pas këmbimit;
- d) datën e marrjes së urdhërpagesës.

Neni 42

Informacioni për përfituesin e pagesës pas ekzekutimit të pagesës

Ofruesi i shërbimeve të pagesave të përfituesit të pagesës, menjëherë pas ekzekutimit të transaksionit të pagesës, i jep ose i mundëson përfituesit të pagesës, në të njëjtën mënyrë siç parashikohet në pikën 1, të nenit 37, të këtij ligji, të gjitha të dhënat e mëposhtme, në lidhje me shërbimet e veta:

- a) referencën, që i mundëson përfituesit të pagesës, identifikimin e transaksionit të pagesës dhe, kur është e mundshme, paguesin dhe çdo informacion që është transferuar me transaksionin e pagesës;
- b) shumën e transaksionit të pagesës, në monedhën në të cilën fondet janë në dispozicion të përfituesit të pagesës;
- c) shumën e tarifës së paguar për transaksionin e pagesës nga përfituesi i pagesës dhe, kur është e zbatueshme, një ndarje në zëra të shumës së tarifave;

- ç) kur është e zbatueshme, kursin e këmbimit të përdorur në transaksionin e pagesës nga ofruesi i shërbimit të pagesës të përfituesit të pagesës, dhe shumën e transaksionit të pagesës para këmbimit;
- d) datëvalutën e kreditimit.

KREU III

KONTRATA TIP

Neni 43

Fusha e zbatimit

1. Ky kre zbatohet për transaksionet e pagesave të rregulluara nga një kontratë tip.
2. Banka e Shqipërisë, me akt nënligjor, mund të përcaktojë kërkesa më të thjeshtuara informimi për kategori të caktuara të ofruesve të shërbimeve të pagesave, bazuar në shërbimet që ata ofrojnë, shumat respektive e rreziqet për përdoruesit e shërbimeve të pagesave.

Neni 44

Informacioni i përgjithshëm paraprak

1. Ofruesi i shërbimeve të pagesave, përpara se përdoruesi i shërbimeve të pagesave të nënshkruajë kontratën tip ose të angazhohet nëpërmjet një oferte, i jep përdoruesit të shërbimeve të pagesave, në letër ose në një formë tjetër të qëndrueshme komunikimi, informacionin dhe kushtet e përcaktuara në nenin 45, të këtij ligji. Informacioni dhe kushtet shprehen, të paktën në gjuhën shqipe, me fjalë lehtësisht të kuptueshme e në një formë të qartë.
2. Nëse kontrata tip është lidhur me kërkesën e përdoruesit të shërbimit të pagesave, duke përdorur një mjet të komunikimit në distancë, që nuk i lejon ofruesit të shërbimit të pagesave pajtueshmërinë me pikën 1, të këtij neni, ofruesi i shërbimit të pagesave përmbush detyrimet e tij sipas kësaj pike, menjëherë pas lidhjes së kontratës tip.
3. Ofruesi mund të përmbushë detyrimet që rrjedhin nga pika 1, e këtij neni, edhe duke i dhënë përfituesit të shërbimeve të pagesave një kopje të projektkontratës tip, në të cilën përfshihen informacioni dhe kushtet e përcaktuara në nenin 45, të këtij ligji.

Neni 45

Informacioni dhe kushtet

Ofruesi i shërbimeve të pagesave i paraqet përdoruesit të shërbimeve të pagesave informacionin dhe kushtet, si më poshtë vijon:

a) Për ofruesin e shërbimeve të pagesave:

- i. emrin e ofruesit të shërbimeve të pagesave, adresën e selisë qendrore dhe, sipas rastit, adresën e agjentit apo të degës së tij, ku ofrohen shërbimet e pagesave, dhe çdo adresë tjetër, përfshirë adresën e postës elektronike, që përdoret për komunikim me ofruesin e shërbimeve të pagesave;
- ii. të dhëna identifikuese për regjistrimin në regjistrin e Bankës së Shqipërisë, sipas nenit 16, të këtij ligji;

b) Për përdorimin e shërbimeve të pagesave:

- i. një përshkrim të karakteristikave kryesore të shërbimeve të pagesave që ofrohen;
- ii. një specifikim të informacionit ose të kodit unik të identifikimit, që jepet nga përdoruesi i shërbimeve të pagesave, me qëllim iniciimin ose ekzekutimin e saktë të një urdhërpagese;
- iii. formën dhe procedurën për dhënien e pëlqimit për iniciimin e një urdhërpagese ose për ekzekutimin e një transaksioni pagese, si dhe për tërheqjen e një pëlqimi të tillë, në përputhje me nenet 57 e 73, të këtij ligji;
- iv. referencë për afatin kohor të marrjes së urdhërpagesës, në përputhje me nenin 71, të këtij ligji, dhe kohën e ndërprerjes (*cut-off*) nëse ka, të vendosur nga ofruesi i shërbimeve të pagesave;
- v. kohën maksimale të ekzekutimit për shërbimet e pagesave që ofrohen;
- vi. nëse ekziston një mundësi për të rënë dakord mbi kufirin e shpenzimit për përdorimin e instrumentit të pagesës, në përputhje me pikën 1, të nenit 61, të këtij ligji;
- vii. të drejtat e përdoruesit, në rastin e një instrumenti pagese të bazuar në kartë (*card-based*) ose të bazuar në simbole të përbashkëta (*co-badged*);

c) Për tarifën, normat e interesit dhe kurset e këmbimit:

- i. të gjitha tarifën e pagueshme nga përdoruesi i shërbimeve të pagesave tek ofruesi i shërbimeve të pagesave, duke përfshirë edhe ato që lidhen me mënyrën dhe shpeshtësinë me të cilën informacioni i parashikuar sipas këtij ligji jepet ose vihet në dispozicion dhe, kur është e zbatueshme, ndarja në zëra e shumave të këtyre tarifave;
- ii. aty ku është e zbatueshme, normat e interesit dhe kursi i këmbimit që aplikohen, ose, nëse përdoren norma interesi dhe kurs këmbimi referencë, metodën e llogaritjes së interesit aktual, si edhe datën

përkatëse dhe indeksin ose bazën për përcaktimin e interesit apo kursin e këmbimit referencë;

- iii. nëse bihet dakord, zbatimin e menjëhershëm të ndryshimeve në normën e interesit apo kursin e këmbimit referencë dhe kërkesat për informim që lidhen me ndryshimet në përputhje me pikën 2, të nenit 47, të këtij ligji;

ç) Për komunikimin:

- i. aty ku është e zbatueshme, mjetet e komunikimit, duke përfshirë kërkesat teknike për pajisjet dhe programet e përdoruesit të shërbimeve të pagesave, të dakorduara ndërmjet palëve për transmetimin e informacionit apo të njoftimeve, sipas këtij ligji;
- ii. mënyrën dhe shpeshtësinë me të cilën informacioni jepet ose vihet në dispozicion sipas këtij ligji;
- iii. gjuhën ose gjuhët në të cilën/at lidhet kontrata tip dhe mbahet komunikimi ndërmjet palëve, gjatë kësaj marrëdhënieje kontraktore;
- iv. të drejtën e përdoruesit të shërbimeve të pagesave për të marrë kushtet e parashikuara në kontratën tip, si dhe informacionin e kushtet, në përputhje me nenin 46, të këtij ligji;

d) Për masat mbrojtëse dhe veprimet korrigjuese:

- i. aty ku është e zbatueshme, një përshkrim të hapave që përdoruesi i shërbimeve të pagesave duhet të ndërmarrë, në mënyrë që të mbajë të sigurt një instrument pagese, si dhe mënyrën e njoftimit të ofruesit të shërbimeve të pagesave për qëllime të shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 62, të këtij ligji;
- ii. procedurën e sigurt për njoftimin e përdoruesit të shërbimeve të pagesave nga ofruesi i shërbimeve të pagesave, në rast mashtrimi ose dyshimi për mashtrim, ose në rast të kërcënimeve të sigurisë;
- iii. nëse është rënë dakord, kushtet sipas të cilave ofruesi i shërbimeve të pagesave rezervon të drejtën për të bllokuar një instrument pagese, në përputhje me nenin 61, të këtij ligji;
- iv. detyrimin e paguesit, në përputhje me nenin 67, të këtij ligji, duke përfshirë informacion mbi shumën përkatëse;
- v. mënyrën dhe periudhën brenda së cilës përdoruesi i shërbimeve të pagesave njofton ofruesin e shërbimeve të pagesave për çdo transaksion pagese të paautorizuar ose të iniciuar apo të ekzekutuar gabimisht, në përputhje me nenin 64, të këtij ligji, si dhe mbi detyrimin e ofruesit të shërbimeve të pagesave për transaksionet e pagesave të paautorizuara, në përputhje me nenin 66, të këtij ligji;
- vi. detyrimin e ofruesit të shërbimit të pagesave për iniciimin ose ekzekutimin e transaksioneve të pagesave, në përputhje me nenin 82, të

- këtij ligji; dhe
- vii. kushtet për rimbursim, në përputhje me nenet 69 e 70, të këtij ligji;

e) Për ndryshimet dhe zgjidhjen e kontratës tip:

- i. nëse është rënë dakord, informacionin, i cili tregon se ndryshimet e kushteve, sipas përcaktimeve të nenit 47, të këtij ligji, konsiderohen të jenë pranuar nga përdoruesi i shërbimeve të pagesave, me përjashtim të rastit kur ai ka njoftuar ofruesin e shërbimeve të pagesave se nuk i pranon ndryshimet, përpara datës së propozuar të hyrjes së tyre në fuqi;
- ii. kohëzgjatjen e kontratës tip;
- iii. të drejtën e përdoruesit të shërbimeve të pagesave për të zgjidhur kontratën tip dhe çdo marrëveshje që ka lidhje me zgjidhjen, në përputhje me pikën 1, të nenit 47, dhe nenin 48, të këtij ligji;

ë) Për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve:

- i. legjislacionin e zbatueshëm dhe gjykatën kompetente;
- ii. procedurat e zbatueshme për zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve, sipas neneve 92 e 93, të këtij ligji.

Neni 46

Aksesi për informacionin dhe kushtet e kontratës tip

Përdoruesi i shërbimeve të pagesave ka të drejtë që, në çdo kohë, gjatë marrëdhënies kontraktore, të bëjë kërkesë për të marrë në format *hard copy* ose me mjete të tjera të qëndrueshme komunikimi, kushtet e kontratës tip, si dhe informacionin e kushtet e specifikuar në nenin 45, të këtij ligji.

Neni 47

Ndryshimet në kushtet e kontratës tip

1. Çdo ndryshim në kontratën tip, si dhe në informacionin e kushtet e përcaktuara në nenin 45, të këtij ligji, propozohet nga ofruesi i shërbimeve të pagesave në të njëjtën mënyrë siç përcaktohet në pikën 1, të nenit 44, të këtij ligji, dhe jo më vonë se 2 (dy) muaj përpara datës së propozuar për fillimin e zbatimit të tyre. Përdoruesi i shërbimeve të pagesave mund të pranojë ose të refuzojë ndryshimet përpara datës së propozuar të hyrjes së tyre në fuqi.
2. Aty ku është e zbatueshme, në përputhje me nënndarjen “i”, të shkronjës “dh”, të nenit 45, të këtij ligji, ofruesi i shërbimeve të pagesave informon përdoruesin e shërbimeve të pagesave që ai do të konsiderohet se i ka pranuar këto ndryshime, nëse përpara datës së propozuar të hyrjes së tyre në fuqi, nuk e njofton ofruesin e shërbimeve të pagesave për mospranimin e

ndryshimeve. Ofruesi i shërbimeve të pagesave informon përdoruesin e shërbimeve të pagesave që, në rast se përdoruesi i shërbimeve të pagesave i refuzon ndryshimet, atëherë ai ka të drejtë të zgjidhë kontratën tip pa penalitet dhe me efekte vepruese në çdo moment përpara datës së propozuar për zbatimin e ndryshimeve.

3. Ndryshimet në normat e interesit ose të kurseve të këmbimit mund të zbatohen menjëherë dhe pa paralajmërim, me kusht që një e drejtë e tillë të jetë dakordësuar në kontratën tip dhe që ndryshimet të jenë të bazuara në norma interesi referencë apo kurse këmbimi referencë, për të cilat është rënë dakord, në përputhje me nënndarjet “ii” dhe “iii”, të shkronjës “c”, të nenit 45, të këtij ligji. Përdoruesi i shërbimeve të pagesave informohet sa më shpejt të jetë e mundur për çdo ndryshim në normën e interesit, në të njëjtën mënyrë siç parashikohet në pikën 1, të nenit 44, të këtij ligji, me përjashtim të rastit kur palët kanë rënë dakord për një periudhë të caktuar kohore apo për mënyrën në të cilën duhet dhënë ose vënë në dispozicion informacioni. Ndryshimet e normës së interesit ose të kursit të këmbimit që janë më të favorshme për përdoruesit e shërbimeve të pagesave mund të aplikohen edhe pa njoftim.
4. Ndryshimet e normës së interesit ose të kursit të këmbimit të përdorur në transaksionet e pagesave zbatohen e llogariten në mënyrë neutrale dhe jodiskriminuese ndaj përdoruesve të shërbimeve të pagesave.

Neni 48 **Zgjidhja e kontratës**

1. Përdoruesi i shërbimeve të pagesave mund të zgjidhë kontratën tip në çdo kohë, përveç rasteve kur palët kanë rënë dakord që zgjidhja të paraprihet nga një periudhë njoftimi. Në çdo rast kjo periudhë nuk mund të jetë më e gjatë se një muaj.
2. Zgjidhja e kontratës për përdoruesin e shërbimeve të pagesave bëhet pa penalitet, përveç rasteve kur kontrata ka qenë në fuqi për më pak se 6 (gjashtë) muaj. Në këtë rast penalitetet për zgjidhjen e kontratës tip duhet të jenë të përshtatshme dhe në përputhje me kostot.
3. Nëse është rënë dakord në kontratën tip, ofruesi i shërbimeve të pagesave mund të zgjidhë kontratën tip të lidhur për një periudhë të pacaktuar, duke njoftuar të paktën 2 (dy) muaj përpara, në të njëjtën mënyrë siç parashikohet në pikën 1, të nenit 44, të këtij ligji.

4. Tarifat për shërbimet e pagesave të vendosura rregullisht paguhet nga ana e përdoruesit të shërbimeve të pagesave vetëm në mënyrë proporcionale deri në zgjidhjen e kontratës. Nëse këto tarifa janë paguar paraprakisht, ato rimbursohen në mënyrë proporcionale.

Neni 49

Informacioni përpara ekzekutimit të transaksioneve individuale të pagesave

1. Në rastin e një transaksioni individual pagese të iniciuar nga paguesi, në bazë të një kontrate tip, ofruesi i shërbimeve të pagesave, me kërkesë të paguesit, për këtë transaksion specifik pagese, i jep informacion të qartë për:
 - a) kohën maksimale të ekzekutimit;
 - b) tarifat e pagueshme nga paguesi;
 - c) një ndarje në zëra të shumave të çdo tarife, kur është e zbatueshme.
2. Banka e Shqipërisë mund të kërkojë dhënien e informacioneve shtesë nga ofruesit e shërbimeve të pagesave sipas këtij neni.

Neni 50

Informimi i paguesit për transaksionet individuale të pagesave

1. Ofruesi i shërbimeve të pagesave të paguesit, pasi ka debituar shumën e transaksionit individual të pagesës në llogarinë e paguesit ose në rastin kur paguesi nuk përdor llogari pagese, pas marrjes së urdhërpagesës, i jep paguesit pa vonesa të panevojshme dhe në të njëjtën mënyrë siç përcaktohet në pikën 1, të nenit 44, të këtij ligji, informacionin e mëposhtëm:
 - a) referencën, që i mundëson paguesit të identifikojë çdo transaksion pagese dhe, kur është e përshtatshme, informacionin lidhur me përfituesin e pagesës;
 - b) shumën e transaksionit të pagesës në monedhën në të cilën debitohet llogaria e pagesës së paguesit ose në monedhën e përdorur në urdhërpagesë;
 - c) shumën e çdo tarife për transaksionin e pagesës dhe, kur është e zbatueshme, ndarjen e tyre në zëra apo interesin që duhet të paguhet nga paguesi;
 - ç) kursin e këmbimit të përdorur në transaksionin e pagesës nga ofruesi i shërbimeve të pagesave të paguesit, kur kjo është e zbatueshme, dhe shumën e transaksionit të pagesës pas këmbimit;
 - d) datëvalutën e debitimit ose datën e marrjes së urdhërpagesës.

2. Kontrata tip përfshin kushtin që, sipas kërkesës së paguesit, informacioni sipas pikës 1, të këtij neni, të jepet ose të vihet në dispozicion periodikisht, të paktën 1 (një) herë në muaj, pa pagesë dhe sipas mënyrës së rënë dakord e që i lejon paguesit të ruajë e të riprodhojë informacionin e pandryshuar.
3. Ofruesi i shërbimeve të pagesave i ofron paguesit informacionin sipas pikës 1, të këtij neni, në format *hard copy* ose me mjete të tjera të qëndrueshme komunikimi, të paktën 1 (një) herë në muaj, pa pagesë.

Neni 51

Informimi për përfituesin e pagesës për transaksionet e pagesave individuale

1. Ofruesi i shërbimeve të pagesave të përfituesit të pagesës i jep këtij të fundit, pas ekzekutimit të transaksionit individual të pagesës, pa vonesa të panevojshme dhe në të njëjtën mënyrë siç përcaktohet në pikën 1, të nenit 44, të këtij ligji, informacionin e mëposhtëm:
 - a) referencën, që i mundëson përfituesit të pagesës identifikimin e transaksionit të pagesës dhe paguesin, si dhe çdo informacion që është transferuar me transaksionin e pagesës;
 - b) shumën e transaksionit të pagesës në monedhën në të cilën është kredituar llogaria e përfituesit të pagesës;
 - c) shumën e çdo tarife për transaksionin e pagesës dhe, aty ku është e zbatueshme, ndarjen e tyre në zëra apo interesin që duhet të paguhet nga përfituesi i pagesës;
 - ç) kur është e zbatueshme, kursin e këmbimit të përdorur në transaksionin e pagesës nga ofruesi i shërbimeve të pagesave të përfituesit të pagesës, si dhe shumën e transaksionit të pagesës para këmbimit;
 - d) datëvalutën e kreditimit.
2. Kontrata tip përfshin kushtin që, sipas kërkesës së përfituesit, informacioni sipas pikës 1, të këtij neni, të jepet ose të vihet në dispozicion periodikisht, të paktën 1 (një) herë në muaj, pa pagesë, dhe sipas mënyrës për të cilën është rënë dakord e që i lejon përfituesit të pagesës të ruajë e të riprodhojë informacionin e pandryshuar.
3. Ofruesi i shërbimeve të pagesave i ofron përfituesit të pagesës informacion sipas pikës 1, të këtij neni, në format *hard copy* ose me mjete të tjera të qëndrueshme komunikimi, të paktën 1 (një) herë në muaj, pa pagesë.

KREU IV

DISPOZITA TË PËRBASHKËTA

Neni 52
Monedha dhe këmbimi i monedhave

1. Pagesat bëhen në monedhën kombëtare ose në monedhën e rënë dakord ndërmjet palëve.
2. Kur shërbimi i këmbimit të monedhës ofrohet para iniciimit të transaksionit të pagesës dhe kur ky shërbim ofrohet në ATM, në pikën e shitjes ose nga përfituesi i pagesës, pala që ofron shërbimin e këmbimit të monedhës për pagesin i bën të ditur paguesit të gjitha tarifat dhe kursin e këmbimit.
3. Mbi këtë bazë, paguesi duhet të bjerë dakord për shërbimin e këmbimit të monedhës, sipas pikës 2, të këtij neni.

Neni 53
Informimi për tarifa të tjera shtesë ose zbritjet

1. Përfituesi i pagesës, në rastin kur kërkon një tarifë ose bën një zbritje për përdorimin e një instrumenti të caktuar pagese, informon paguesin, përpara iniciimit të transaksionit të pagesës.
2. Ofruesi i shërbimeve të pagesave apo një palë e tretë e përfshirë në transaksion, në rastin kur kërkon një tarifë për përdorimin e një instrumenti të caktuar pagese, njofton përdoruesin e shërbimeve të pagesave përpara iniciimit të transaksionit të pagesës.
3. Paguesi paguan për tarifat e përmendura në pikat 1 e 2, të këtij neni, vetëm nëse shuma e tyre e plotë është bërë e ditur përpara iniciimit të transaksionit të pagesës.

TITULLI IV
TË DREJTAT DHE DETYRIMET LIDHUR ME OFRIMIN
E PËRDORIMIN E SHËRBIMEVE TË PAGESAVE

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 54
Fusha e zbatimit

1. Ofruesi i shërbimeve të pagesave dhe përdoruesi i shërbimeve të pagesave mund të bien dakord që, kur përdoruesi i shërbimeve të pagesave nuk është konsumator, pika 1, e nenit 55, pika 5, e neni 57, dhe nenet 65, 67, 69, 70, 73

e 82 të këtij ligji, të mos aplikohen tërësisht ose pjesërisht. Përdoruesi i shërbimeve të pagesave dhe ofruesi i shërbimeve të pagesave mund të bien dakord për zbatimin e afateve kohore të ndryshme nga ato që përcaktohen në nenin 64, të këtij ligji.

2. Procedurat e zgjidhjes alternative të mosmarrëveshjeve të parashikuara në nenet 92 e 93, të këtij ligji, zbatohen vetëm për konsumatorët dhe mikrondërmarrjet. Dispozitat e këtij titulli janë të zbatueshme për mikrondërmarrjet në të njëjtën mënyrë si për konsumatorët.
3. Dispozitat e këtij ligji nuk cenojnë zbatimin e legjislacionit shqiptar lidhur me kushtet e dhënies së kredive konsumatore, të cilat nuk janë të rregulluara nga ky ligj.
4. Titulli IV, me përjashtim të neneve 74 deri në 78 e 80, të këtij ligji, zbatohet për pagesat kombëtare në monedhë të huaj, si në rastin kur pagesa kryhet ndërmjet dy ofruesve të shërbimeve të pagesave, atë të paguesit dhe atë të përfituesit, ashtu dhe kur ofruesi i shërbimit të pagesave të paguesit dhe përfituesit është i njëjtë për atë pjesë të pagesës që kryhet brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.
5. Titulli IV, me përjashtim të neneve 55, pikat 2 dhe 4, të neneve 69, 70, 74, 76, pika 1, dhe të neneve 82 e 85, të këtij ligji, zbatohet dhe për pagesat ndërkufitare, për sa i përket pjesës së transaksionit të pagesës së kryer brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

Neni 55

Tarifat e zbatueshme

1. Ofruesi i shërbimeve të pagesave nuk vendos tarifa për përdoruesin e shërbimeve të pagesave, për përmbushjen e detyrimeve të tij për dhënie informacioni ose për masat korrigjuese dhe parandaluese sipas këtij titulli, me përjashtim të rasteve kur specifikohet ndryshe sipas neneve 72, pikat 1, 2 e 3, 73, pika 5, dhe 81, pika 2, të këtij ligji. Këto tarifa vendosen në dakordësi ndërmjet përdoruesit dhe ofruesit të shërbimeve të pagesave dhe duhet të jenë të përshtatshme e të bazuara në kostot reale të ofruesit të shërbimeve të pagesave.
2. Për pagesa të kryera brenda Republikës së Shqipërisë, paguesi dhe përfituesi i pagesës paguajnë tarifën e vëna përkatësisht nga ofruesit e tyre të shërbimeve të pagesave, si në rastin kur ofruesit e tyre të pagesave operojnë

brenda vendit, ashtu edhe kur transaksioni kryhet brenda të njëjtit ofrues të shërbimeve të pagesave.

3. Ofruesi i shërbimeve të pagesave nuk pengon përfituesin e pagesës t'i kërkojë paguesit një tarifë, t'i ofrojë një zbritje apo ta drejtojë drejt përdorimit të një instrumenti të caktuar pagese. Tarifat e aplikuara në këtë pikë nuk duhet të tejkalojnë kostot e drejtpërdrejta të mbartura nga përfituesi i pagesës për përdorimin e instrumentit të caktuar të pagesës.
4. Banka e Shqipërisë, për instrumente të caktuara të pagesës, mund të ndalojë ose të kufizojë të drejtën e përfituesit të pagesës për të kërkuar tarifa, duke marrë parasysh nevojën për të nxitur konkurrencën dhe për të promovuar përdorimin e këtij instrumenti pagese.

Neni 56

Përjashtime për instrumentet e pagesave me vlera të vogla dhe për paranë elektronike

1. Në rastet e instrumenteve të pagesave, të cilat, sipas kontratës përkatëse tip, nuk tejkalojnë limitet e përcaktuara në aktet nënligjore të Bankës së Shqipërisë, që në çdo rast nuk tejkalojnë shumën prej 4 000 (katër mijë) lekësh për një transaksion individual pagese, ose kanë një limit shpenzimi në shumën 20 000 (njëzet mijë) lekë, ose ruajnë vlera që nuk tejkalojnë shumën prej 20 000 (njëzet mijë) lekësh për pagesat me vlerë të vogël ose për paranë elektronike, në çdo kohë, ofruesit e shërbimeve të pagesave mund të bien dakord me përdoruesit e shërbimeve të pagesave që:
 - a) shkronja “b”, e pikës 1 të nenit 62, shkronjat “c” dhe “ç”, të pikës 1, të nenit 63, si dhe pikat 5 e 6, të nenit 67, të këtij ligji, nuk zbatohen nëse instrumenti i pagesës nuk lejon bllokimin e tij ose parandalimin e përdorimit të mëtejshëm të tij;
 - b) nenet 65, 66 e 67, pikat 1, 2, 3, 5 dhe 6, të këtij ligji, nuk zbatohen nëse instrumenti i pagesës përdoret në mënyrë anonime ose ofruesi i shërbimit të pagesave nuk është në gjendje të provojë, për arsye të tjera thelbësore në lidhje me instrumentin e pagesës, se transaksioni i pagesës ishte i autorizuar;
 - c) në përjashtim nga pikat 1 dhe 2, të nenit 72, të këtij ligji, ofruesi i shërbimeve të pagesave nuk është i detyruar të njoftojë përdoruesin e shërbimeve të pagesave për refuzimin e urdhërpagesës në qoftë se mosekzekutimi është i dukshëm nga rrethanat;
 - ç) në përjashtim nga neni 73, i këtij ligji, paguesi nuk revokon urdhërpagesën pas transmetimit të saj ose pasi i ka dhënë përfituesit të pagesës pëlqimin e tij për të ekzekutuar transaksionin e pagesës;

- d) në përjashtim nga nenet 76 e 77, të këtij ligji, zbatohen periudha të tjera ekzekutimi.
2. Për transaksionet e pagesave brenda vendit, Banka e Shqipërisë, me akt nënligjor, mund të ulë ose të dyfishojë limitet sipas pikës 1 të këtij neni. Për instrumentet e pagesave të parapaguara limiti mund të rritet deri në një nivel të përcaktuar me akt nënligjor të Bankës së Shqipërisë.
 3. Nenet 66 e 67, të këtij ligji, zbatohen edhe për paranë elektronike, sipas përkufizimit në legjislacionin në fuqi për bankat, me përjashtim të rasteve kur ofruesi i shërbimeve të pagesave të paguesit nuk ka mundësinë të bllokojë llogarinë e pagesës në të cilën ruhet paraja elektronike ose të bllokojë instrumentin e pagesës.
 4. Banka e Shqipërisë mund të kufizojë përjashtimin e pikës 3, të këtij neni, për llogaritë e pagesave në të cilat ruhet paraja elektronike apo për instrumentet e pagesave me një vlerë të caktuar.

KREU II

AUTORIZIMI I TRANSAKSIONEVE TË PAGESAVE

Neni 57

Dhënia dhe tërheqja e pëlqimit

1. Transaksioni i pagesës konsiderohet i autorizuar vetëm nëse paguesi ka dhënë pëlqimin për të ekzekutuar transaksionin e pagesës.
2. Transaksioni i pagesës mund të autorizohet nga paguesi përpara ose, nëse bihet dakord ndërmjet paguesit dhe ofruesit të shërbimeve të pagesave pas ekzekutimit të transaksionit të pagesës.
3. Pëlqimi për ekzekutimin e transaksionit të pagesës ose të transaksioneve të njëpasnjëshme të pagesave jepet në formën e rënë dakord ndërmjet paguesit dhe ofruesit të shërbimeve të pagesave. Pëlqimi për ekzekutimin e transaksionit të pagesës mund të jepet gjithashtu nëpërmjet përfituesit të pagesës ose nga ofruesi i shërbimit të iniciimit të pagesës.
4. Në mungesë të dhënies së pëlqimit, transaksioni i pagesës konsiderohet i paautorizuar.
5. Pëlqimi mund të tërhiqet nga paguesi në çdo kohë, por jo më vonë se momenti i parevokueshmërisë sipas nenit 73, të këtij ligji. Pëlqimi për të ekzekutuar transaksionet e njëpasnjëshme të pagesave mund të tërhiqet dhe, në këtë rast, çdo transaksion pageje i ardhshëm konsiderohet i paautorizuar.

6. Procedura për dhënien e pëlqimit dakordësohet ndërmjet paguesit dhe ofruesit përkatës të shërbimeve të pagesave.

Neni 58

Konfirmimi për disponueshmërinë e fondeve

1. Ofruesi i shërbimit të pagesës për shërbimin e llogarisë, bazuar në kërkesën e bërë nga ofruesi i shërbimeve të pagesave, i cili emeton instrumente pagese të llojit kartë (*card-based*), konfirmon menjëherë nëse shuma e nevojshme për ekzekutimin e transaksionit të pagesës me kartë (*card-based*) është e disponueshme në llogarinë e pagesës së paguesit, me kusht që të plotësohen të gjitha kërkesat e mëposhtme:
 - a) llogaria e pagesës së paguesit është e aksesueshme *on-line* në momentin e bërjes së kërkesës;
 - b) paguesi i ka dhënë pëlqimin e tij në mënyrë të qartë ofruesit të shërbimit të pagesës për shërbimin e llogarisë, që ky i fundit t’u përgjigjet kërkesave nga një ofrues i caktuar i shërbimeve të pagesave, për të konfirmuar që shuma që korrespondon me një transaksion të caktuar pagesash të kryer me një kartë, është në dispozicion në llogarinë e pagesës së paguesit;
 - c) pëlqimi sipas shkronjës “b”, të kësaj pike, është dhënë përpara se të bëhet kërkesa e parë për konfirmim.
2. Ofruesi i shërbimeve të pagesave mund të kërkojë konfirmimin sipas pikës 1, të këtij neni, kur plotësohen të gjitha kushtet e mëposhtme:
 - a) paguesi ka dhënë pëlqimin e tij në mënyrë të qartë për ofruesin e shërbimeve të pagesave për të kërkuar konfirmimin sipas pikës 1, të këtij neni;
 - b) paguesi ka iniciuar transaksionin e pagesës nëpërmjet kartës (*card-based*) për shumën në fjalë, duke përdorur një instrument pagese me kartë (*card-based*) të emetuar nga ofruesi i shërbimeve të pagesave;
 - c) ofruesi i shërbimeve të pagesave autentifikon veten ndaj ofruesit të shërbimit të pagesës për shërbimin e llogarisë përpara çdo kërkesë për konfirmim dhe komunikon në mënyrë të sigurt me ofruesin e shërbimit të pagesës për shërbimin e llogarisë, sipas shkronjës “ç”, të pikës 1, të nenit 91, të këtij ligji.
3. Konfirmimi sipas pikës 1, të këtij neni, konsiston vetëm në një përgjigje të thjeshtë “Po” ose “Jo” dhe jo në një deklaratë të gjendjes së llogarisë. Kjo përgjigje nuk ruhet apo përdoret për qëllime të tjera përveçse për ekzekutimin e transaksionit të pagesës me kartë.

4. Konfirmimi sipas pikës 1, të këtij neni, nuk i lejon ofruesit të shërbimit të pagesës për shërbimin e llogarisë të bllokojë fondet në llogarinë e pagesës së paguesit.
5. Paguesi mund të kërkojë nga ofruesi i shërbimit të pagesës për shërbimin e llogarisë t'i komunikojë identifikimin e ofruesit të shërbimeve të pagesave dhe përgjigjen e dhënë.
6. Ky nen nuk zbatohet për transaksionet e pagesave të iniciuara nëpërmjet instrumenteve të pagesave me kartë, në të cilat ruhet paraja elektronike e përkufizuar në legjislacionin në fuqi për bankat.

Neni 59

Rregullat për aksesin në llogarinë e pagesës, në rastin e shërbimeve të iniciimit të pagesës

1. Me përjashtim të rasteve kur një llogari pagese nuk është e aksesueshme *on-line*, paguesi ka të drejtën e përdorimit të një ofruesi të shërbimit të iniciimit të pagesës për të marrë shërbimet e pagesave, të përcaktuara në pikën 7, të aneksit 1, të këtij ligji.
2. Kur paguesi jep pëlqimin e tij në mënyrë të qartë për ekzekutimin e një pagese në përputhje me nenin 57, të këtij ligji, ofruesi i shërbimit të pagesës për shërbimin e llogarisë kryen veprimet e përcaktuara në pikën 4, të këtij neni, në mënyrë që të sigurojë të drejtën e paguesit për të përdorur shërbimin e iniciimit të pagesës.
3. Ofruesi i shërbimit të iniciimit të pagesës:
 - a) në asnjë moment nuk mban fonde të paguesit të lidhura me ofrimin e shërbimit të iniciimit të pagesës;
 - b) siguron që kredencialet e personalizuar të sigurisë së përdoruesit të shërbimeve të pagesave, me përjashtim të vetë përdoruesit dhe emetuesit të kredencialeve të personalizuar të sigurisë, nuk janë të aksesueshme nga palët e tjera, si dhe transmetohen nga ofruesi i shërbimit të iniciimit të pagesës nëpërmjet kanaleve të sigurta dhe efikase;
 - c) siguron që çdo informacion tjetër lidhur me përdoruesin e shërbimeve të pagesave, i përftuar gjatë ofrimit të shërbimeve të iniciimit të pagesës, t'i jepet vetëm përfituesit të pagesës dhe vetëm me pëlqimin e qartë të përdoruesit të shërbimeve të pagesave;
 - ç) sa herë që iniciohet një pagesë, autentifikon veten ndaj ofruesit të shërbimeve të pagesave për shërbimin e llogarisë së paguesit dhe komunikon me ofruesin e shërbimit të pagesave për shërbimin e llogarisë, me paguesin dhe me përfituesin e pagesës, në përputhje me shkronjën

“ç”, të pikës 1, të nenit 91, të këtij ligji;

- d) nuk ruan të dhënat sensitive të përdoruesit të shërbimeve të pagesave;
- dh) nuk kërkon nga përdoruesit e shërbimeve të pagesave të dhëna të tjera përtej atyre të nevojshme për ofrimin e shërbimit të iniciimit të pagesës;
- e) nuk përdor, akseson apo ruan të dhëna për qëllime të tjera përveçse për ofrimin e shërbimit të iniciimit të pagesës, sipas kërkesës së qartë të paguesit;
- ë) nuk modifikon shumën, përfituesin e pagesës apo ndonjë karakteristikë tjetër të transaksionit.

4. Ofruesi i shërbimit të pagesës për shërbimin e llogarisë:

- a) komunikon në mënyrë të sigurt me ofruesit e shërbimeve të iniciimit të pagesës sipas shkronjës “ç”, të pikës 1, të nenit 91, të këtij ligji;
- b) menjëherë pas marrjes së urdhërpagesës nga një ofrues i shërbimit të iniciimit të pagesës, jep ose vë në dispozicion të gjithë informacionin e mundur për iniciimin e transaksionit të pagesës dhe të gjithë informacionin e aksesueshëm nga ofruesi i shërbimit të pagesës për shërbimin e llogarisë, në lidhje me ekzekutimin e transaksionit të pagesës të ofruesit të shërbimit të iniciimit të pagesës;
- c) trajton urdhërpagesat e transmetuara nëpërmjet shërbimeve të një ofruesi të shërbimit të iniciimit të pagesës pa diskriminim, përveçse për arsye objektive, në veçanti për sa i përket kohës, prioriteteve apo tarifave, në lidhje me urdhërpagesat e transmetuara drejtpërdrejt nga paguesi.

5. Ekzistenca e një marrëdhënieje kontraktore ndërmjet ofruesit të shërbimit të iniciimit të pagesës dhe ofruesit të shërbimit të pagesave për shërbimin e llogarisë nuk është kusht për ofrimin e shërbimeve të iniciimit të pagesës për këtë qëllim.

Neni 60

Rregullat për aksesin dhe përdorimin e informacionit për llogarinë e pagesës në rastin e shërbimit të informimit të llogarisë

- 1. Me përjashtim të rasteve kur llogaria e pagesës nuk është e aksesueshme *on-line*, përdoruesi i shërbimeve të pagesave gëzon të drejtën e përdorimit të shërbimeve, të cilat mundësojnë aksesin e informimit të llogarisë, sipas pikës 8, të aneksit 1, të këtij ligji.
- 2. Ofruesi i shërbimit të informimit të llogarisë:
 - a) ofron shërbime vetëm kur përdoruesi i shërbimeve të pagesave ka dhënë në mënyrë të qartë pëlqimin e tij;

- b) garanton se kredencialet e personalizuara të sigurisë së përdoruesit të shërbimeve të pagesave, me përjashtim të vetë përdoruesit të shërbimeve të pagesave dhe emetuesit të këtyre kredencialeve, nuk janë të aksesueshme nga palë të tjera dhe, kur këto kredenciale transmetohen nga ofruesi i shërbimit të informimit të llogarisë, ky transmetim bëhet me kanale të sigurta dhe efikase;
 - c) për çdo seancë komunikimi, identifikon veten kundrejt ofruesit të shërbimit të pagesës për shërbimin e llogarisë së përdoruesit të shërbimeve të pagesave dhe komunikon në mënyrë të sigurt me ofruesin e shërbimeve të pagesave për shërbimin e llogarisë dhe përdoruesin e shërbimeve të pagesave sipas shkronjës “ç”, të pikës 1, të nenit 91, të këtij ligji;
 - ç) akseson vetëm informacionin nga llogari pagesash të caktuara dhe transaksionet e pagesave të lidhura me këto llogari;
 - d) nuk kërkon të dhëna sensitive të pagesave që lidhen me llogaritë e pagesave;
 - dh) nuk përdor, akseson ose ruan ndonjë të dhënë për qëllime të tjera nga kryerja e shërbimit të informimit të llogarisë të kërkuar në mënyrë të qartë nga përdoruesi i shërbimeve të pagesave, në përputhje me rregullat për mbrojtjen e të dhënave.
3. Lidhur me llogarinë e pagesave, ofruesi i shërbimit të pagesës të shërbimit të llogarisë:
- a) komunikon në mënyrë të sigurt me ofruesit e shërbimit të informimit të llogarisë, sipas shkronjës “ç”, të pikës 1, të nenit 91, të këtij ligji; dhe
 - b) trajton kërkesat për transmetimin e të dhënave, nëpërmjet shërbimeve të ofruesit të shërbimit të informimit të llogarisë, pa ndonjë diskriminim përveçse për arsye objektive.
4. Ekzistenca e një marrëdhënieje kontraktore ndërmjet ofruesit të shërbimit të informimit të llogarisë dhe ofruesit të shërbimit të pagesës për shërbimin e llogarisë nuk është kusht për ofrimin e shërbimit të informimit të llogarisë për këtë qëllim.

Neni 61

Kufijtë e përdorimit të instrumentit të pagesës dhe të aksesit në llogaritë e pagesës nga ofruesi i shërbimeve të pagesave

1. Kur një instrument pagese përdoret për qëllime të dhënies së pëlqimit, paguesi dhe ofruesi i tij i shërbimeve të pagesave mund të bien dakord për kufijtë e shpenzimeve për transaksionet e pagesave të kryera me këtë instrument pagese.

2. Nëse palët bien dakord në kontratën tip, ofruesit të shërbimeve të pagesave mund t'i rezervohet e drejta të bllokojë instrumentin e pagesave për arsye të justifikuara objektive që lidhen me sigurinë e instrumentit të pagesës, dyshime për përdorimin e paautorizuar ose për qëllime mashtrimi të instrumentit të pagesës ose, në rastin e një instrumenti pagese me linjë kredie, kur paraqitet një rritje e konsiderueshme e rrezikut që paguesi mund të mos jetë në gjendje të përmbushë detyrimin e tij për të paguar.
3. Në rastet e pikës 2, të këtij neni, ofruesi i shërbimeve të pagesave informon paguesin për bllokimin e instrumentit të pagesës dhe për arsyet e këtij bllokimi, në mënyrën e rënë dakord, aty ku është e mundur, përpara bllokimit të instrumentit të pagesës ose së paku menjëherë pas bllokimit, me përjashtim të rasteve kur ky informacion komprometon sigurinë për arsye të justifikuara objektivisht ose është i ndaluar me ligj.
4. Ofruesi i shërbimeve të pagesave zhbllokon instrumentin e pagesës ose e zëvendëson atë me një instrument të ri pagese kur arsyet për bllokim nuk ekzistojnë më.
5. Ofruesi i shërbimit të pagesës së shërbimit të llogarisë mund t'i refuzojë ofruesit të shërbimit të informimit të llogarisë ose ofruesit të shërbimit për iniciimin e pagesës aksesin në llogarinë e pagesës, për arsye objektive të justifikuara e të evidentuara që lidhen me aksesin e paautorizuar ose me qëllim mashtrimi në llogarinë e pagesës nga ofruesi i shërbimit të informimit të llogarisë ose ofruesi i shërbimit të iniciimit të pagesës, duke përfshirë iniciimin e transaksionit të pagesës të paautorizuar ose me qëllim mashtrimi.
6. Në rastin e parashikuar në pikën 5, të këtij neni, ofruesi i shërbimit të pagesës për shërbimin e llogarisë informon paguesin që aksesin i llogarisë është refuzuar, si dhe arsyet përkatëse, sipas formës së dakordësuar ndërmjet palëve. Ky informacion i jepet paguesit, aty ku është e mundur, përpara refuzimit të aksesit ose së paku menjëherë pas refuzimit të tij, përveç rasteve kur dhënia e informacionit komprometon sigurinë për arsye të justifikuara objektivisht ose ndalohet me ligj.
7. Ofruesi i shërbimit të pagesës për shërbimin e llogarisë lejon aksesin në llogarinë e pagesës kur arsyet e refuzimit sipas pikës 5, të këtij neni, nuk ekzistojnë më.
8. Në rastin e parashikuar në pikën 5, të këtij neni, ofruesi i shërbimit të pagesës për shërbimin e llogarisë i raporton menjëherë Bankës së Shqipërisë incidentin lidhur me ofruesin e shërbimit të informimit të llogarisë ose ofruesin e shërbimit të iniciimit të pagesës. Informacioni duhet të përmbajë të gjitha detajet e nevojshme për rastin dhe arsyet e ndërmarrjes së veprimt.

9. Banka e Shqipërisë, pas marrjes së informacionit sipas pikës 8, të këtij neni, vlerëson rastin dhe, nëse është e nevojshme, ndërmerr masat përkatëse.

Neni 62

Detyrimet e përdoruesit të shërbimeve të pagesave lidhur me instrumentet e pagesës dhe kredencialet e personalizuara të sigurisë

1. Përdoruesi i shërbimeve të pagesave, i cili ka të drejtën e përdorimit të një instrumenti pagese:
 - a) përdor instrumentin e pagesës në përputhje me kushtet që rregullojnë emetimin dhe përdorimin e instrumentit të pagesës, të cilat duhet të jenë objektive, jodiskriminuese dhe proporcionale;
 - b) njofton ofruesin e shërbimeve të pagesave ose subjektin e përcaktuar nga ky i fundit, pa vonesë, sapo vihet në dijeni në rast humbjeje, vjedhjeje, keqpërdorimi ose përdorimi të paautorizuar të instrumentit të pagesës.
2. Për qëllimet e shkronjës “a”, të pikës 1, të këtij neni, përdoruesi i shërbimeve të pagesave ndërmerr të gjithë hapat e arsyeshëm për të mbajtur të sigurt kredencialet e personalizuara të sigurisë, në veçanti në momentin e marrjes së instrumentit të pagesës.

Neni 63

Detyrimet e ofruesit të shërbimeve të pagesave lidhur me instrumentet e pagesave

1. Ofruesi i shërbimeve të pagesave, i cili emeton një instrument pagese:
 - a) sigurohet që kredencialet e personalizuara të sigurisë nuk aksesohen nga palë të tjera përveç përdoruesit të shërbimeve të pagesave, i cili gëzon të drejtën të përdorë instrumentin e pagesës pa cenuar detyrimet që ka përdoruesi i shërbimeve të pagesave, sipas nenit 62, të këtij ligji;
 - b) shmang dërgimin e një instrumenti pagese të pakërkuar, përveç rastit kur instrumenti i pagesës që i është dhënë përdoruesit të shërbimeve të pagesave është për t’u zëvendësuar;
 - c) siguron që mjetet e duhura janë në dispozicion në çdo kohë për t’i mundësuar përdoruesit të shërbimeve të pagesave të njoftojë sipas shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 62, të këtij ligji, ose të kërkojë zhbllokimin sipas pikës 4, të nenit 61, të këtij ligji. Në bazë të kërkesës, ofruesi i shërbimeve të pagesave i ofron përdoruesit të shërbimeve të pagesave mjetet për të provuar që ai ka bërë një njoftim të tillë për një periudhë 18 (tetëmbëdhjetë) muaj pas njoftimit;
 - ç) i mundëson përdoruesit të shërbimeve të pagesave një opsion për të bërë

një njoftim sipas shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 62, të këtij ligji pa pagesë dhe e tarifton vetëm për kostot e zëvendësimit, të cilat lidhen direkt me instrumentin e pagesës;

d) parandalon çdolloj përdorimi të instrumentit të pagesës sapo të jetë bërë njoftimi sipas shkronjës “ç”, të kësaj pike.

2. Ofruesi i shërbimeve të pagesave mbart rrezikun e dërgimit të një instrumenti pagese apo të ndonjë kredenciali të personalizuar të sigurisë në lidhje me të përdoruesi i shërbimeve të pagesave.

Neni 64

Njoftimi dhe korrigjimi i transaksioneve të pagesave të paautorizuara ose të ekzekutuara gabimisht

1. Ofruesi i shërbimeve të pagesave kryen korrigjimin e gabimit për llogari të përdoruesit të shërbimeve të pagesave vetëm nëse ky i fundit njofton ofruesin e shërbimeve të pagesave pa vonesë sapo vihet në dijeni për çdo transaksion pagese të paautorizuar ose të ekzekutuar gabimisht, për të cilin mund të lindë e drejta për ndonjë pretendim, përfshirë edhe rastet sipas nenit 82, të këtij ligji, e jo më vonë se afati i përcaktuar në nenin 1022, të Kodit Civil. Ky afat fillon të llogaritet pas datës së debitimit.
2. Limitet kohore për dhënien e njoftimit, sipas pikës 1, të këtij neni, nuk zbatohen kur ofruesi i shërbimeve të pagesave nuk ka dhënë ose nuk ka vënë në dispozicion informacionin për transaksionin e pagesës, sipas titullit III, të këtij ligji.
3. Në rastin kur përfshihet ofruesi i shërbimit të iniciimit të pagesës, ofruesi i shërbimit të pagesës për shërbimin e llogarisë kryen korrigjimin për përdoruesin e shërbimeve të pagesave sipas pikës 1, të këtij neni, pa rënë ndesh me nenet 66, pikat 3 dhe 4, e 82, pika 1, të këtij ligji.

Neni 65

Dëshmi për autentifikimin dhe ekzekutimin e transaksioneve të pagesave

1. Kur përdoruesi i shërbimeve të pagesave mohon të ketë autorizuar ekzekutimin e një transaksioni pagese ose pretendon se transaksioni i pagesës nuk është ekzekutuar në mënyrë korrekte, është detyrë e ofruesit të shërbimeve të pagesave që të provojë se transaksioni i pagesës është autentifikuar, regjistruar me saktësi, është kontabilizuar dhe nuk është cenuar nga ndonjë defekt teknik ose nga ndonjë mangësi tjetër e shërbimit të ofruar nga ofruesi i shërbimeve të pagesave.
2. Nëse transaksioni i pagesës është iniciuar nëpërmjet një ofruesi të shërbimit

të iniciimit të pagesës, ofruesi i shërbimit të iniciimit të pagesës ka detyrimin të vërtetojë, brenda kompetencave të tij, se transaksioni i pagesës ishte autentifikuar, regjistruar me saktësi dhe nuk është cenuar nga ndonjë defekt teknik apo mangësi tjetër, për sa u përket shërbimeve të pagesave për të cilin është përgjegjës.

3. Kur përdoruesi i shërbimeve të pagesave mohon të ketë autorizuar një transaksion pagese të ekzekutuar, përdorimi i një instrumenti pagese të regjistruar nga ofruesi i shërbimeve të pagesave, përfshirë ofruesin e shërbimit të iniciimit të pagesës kur është e përshtatshme, nuk mjafton në vetvete për të vërtetuar që transaksioni i pagesës është autorizuar nga paguesi ose që paguesi ka vepruar me mashtrim ose nuk ka përmbushur qëllimisht apo nga pakujdesia një ose më shumë nga detyrimet e tij, sipas nenit 62, të këtij ligji.
4. Në rastin e pikës 3, të këtij neni, ofruesi i shërbimeve të pagesave, përfshirë, kur është e përshtatshme, edhe ofruesin e shërbimit të iniciimit të pagesës, ofrojnë evidenca mbështetëse për të provuar mashtrimin apo pakujdesinë e rëndë nga ana e përdoruesit të shërbimeve të pagesave.

Neni 66

Përgjegjësia e ofruesit të shërbimeve të pagesave për transaksionet e pagesave të paautorizuara

1. Pa rënë ndesh me nenin 64, të këtij ligji, në rast të një transaksioni pagese të paautorizuar, ofruesi i shërbimeve të pagesave të paguesit rimbursin paguesin menjëherë për shumën e transaksionit të pagesës të paautorizuar dhe, në çdo rast, jo më vonë se në fund të ditës pasardhëse të punës, pasi konstaton ose njoftohet për transaksionin, përveç rasteve kur ofruesi i shërbimeve të pagesave të paguesit ka baza të arsyeshme për të dyshuar për mashtrim dhe i komunikon këto arsye të Banka e Shqipërisë me shkrim.
2. Në rastin e pikës 1, të këtij neni, kur është e zbatueshme, ofruesi i shërbimeve të pagesave të paguesit rikthen llogarinë e debituar të pagesës në gjendjen në të cilën do të kishte qenë nëse transaksioni i paautorizuar i pagesës nuk do të kishte ndodhur, si dhe siguron që datëvaluta e kreditimit për llogarinë e pagesës së paguesit të jetë jo më vonë se data kur ishte debituar shuma.
3. Kur urdhërpagesa iniciohet nëpërmjet ofruesit të shërbimit të iniciimit të pagesës, ofruesi i shërbimit të pagesës për shërbimin e llogarisë rimbursin menjëherë, dhe, në çdo rast, jo më vonë se në fund të ditës pasardhëse të punës, shumën e transaksionit të pagesës së paautorizuar, dhe, kur është e zbatueshme, rikthen llogarinë e pagesës së debituar në gjendjen në të cilën

do të kishte qenë nëse transaksioni i paautorizuar i pagesës nuk do të kishte ndodhur.

4. Nëse ofruesi i shërbimit të iniciimit të pagesës është përgjegjës për kryerjen e transaksionit të paautorizuar të pagesës, kompenson menjëherë ofruesin e shërbimit të pagesës për shërbimin e llogarisë me kërkesën e tij, për humbjet e shkaktuara apo shumat e paguara si pasojë e pagesës për shërbimin e llogarisë të paguesit, përfshirë shumën e transaksionit të paautorizuar të pagesës. Sipas pikës 1, të nenit 65, të këtij ligji, ofruesi i shërbimit të iniciimit të pagesës ka detyrimin për të provuar se në fushën e tij të kompetencës transaksioni i pagesës ishte autentifikuar, regjistruar me saktësi dhe nuk është ndikuar nga një defekt teknik ose mangësi të tjera të lidhura me shërbimin e pagesës për të cilin është përgjegjës.
5. Kompensime të tjera financiare, të ndryshme nga ato të përcaktuara në këtë nen, mund të përcaktohen në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm për kontratën e lidhur ndërmjet paguesit dhe ofruesit të shërbimeve të pagesave ose kontratën e lidhur ndërmjet paguesit dhe ofruesit të shërbimit të iniciimit të pagesës, nëse është e zbatueshme.

Neni 67

Përgjegjësia e paguesit për transaksionet e paautorizuara të pagesës

1. Në përjashtim nga neni 66, paguesi mund të detyrohet të mbulojë humbjen për çdo transaksion të paautorizuar pagese deri në shumën maksimale prej 5 000 (pesë mijë) lekësh, të shkaktuar nga përdorimi i një instrumenti pagese të humbur apo të vjedhur ose nga keqpërdorimi i instrumentit të pagesës.
2. Pika 1, e këtij neni, nuk zbatohet, nëse:
 - a) humbja, vjedhja ose keqpërdorimi i një instrumenti pagese nuk ishte kuptuar nga paguesi përpara pagesës, përveç rastit kur paguesi ka vepruar me mashtrim; ose
 - b) humbja është shkaktuar nga veprimet apo mungesa e veprimit të një punonjësi, agjenti apo dege të një ofruesi të shërbimeve të pagesave ose të një subjekti tek i cili janë kontraktuar aktivitetet e tyre.
3. Paguesi mbart të gjitha humbjet lidhur me çdo transaksion pagese të paautorizuar, në qoftë se ato janë shkaktuar si pasojë e mashtrimit nga paguesi apo si pasojë e mosarritjes së paguesit për të përmbushur një apo më shumë nga detyrimet e përcaktuara në nenin 62, të këtij ligji, qëllimisht apo nga pakujdesia. Në raste të tilla, shuma maksimale sipas pikës 1, të këtij neni, nuk do të zbatohet.

4. Në rastet kur ofruesi i shërbimeve të pagesave të paguesit nuk kërkon autentifikim të thelluar të klientit, paguesi nuk mbart asnjë humbje financiare, përveçse kur paguesi ka kryer mashtrim. Kur përfituesi i pagesës ose ofruesi i shërbimeve të pagesave të përfituesit të pagesës dështon të pranojë autentifikim të thelluar të konsumatorit, i kompenson ofruesit të shërbimeve të pagesave të paguesit dëmin financiar të shkaktuar.
5. Paguesi nuk ka pasoja financiare nga përdorimi i instrumentit të pagesës të humbur, të vjedhur ose të keqpërdorur, pasi njofton sipas shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 62, të këtij ligji, me përjashtim të rasteve kur paguesi ka vepruar me mashtrim ose me pakujdesi të rëndë.
6. Nëse ofruesi i shërbimeve të pagesave nuk ofron në çdo kohë mjetet e duhura për njoftimin e humbjes, vjedhjes ose keqpërdorimit të një instrumenti pagese, ashtu si kërkohet sipas shkronjës “c”, të pikës 1, të nenit 63, të këtij ligji, paguesi nuk është përgjegjës për pasojat financiare që rezultojnë nga përdorimi i këtij instrumenti pagese, me përjashtim të rasteve kur ai ka vepruar në kushtet e mashtrimit.

Neni 68

Transaksionet e pagesës kur shuma e transaksionit nuk dihet paraprakisht

1. Kur një transaksion pagese iniciohet nga/ose nëpërmjet përfituesit të pagesës, në rastin e një pagese bazuar në kartë dhe kur shuma e saktë nuk dihet në momentin kur paguesi jep pëlqimin për të ekzekutuar transaksionin e pagesës, ofruesi i shërbimeve të pagesave të paguesit mund të bllokojë fondet në llogarinë e pagesës së paguesit vetëm nëse paguesi ka dhënë pëlqimin për shumën e fondeve që do të bllokohen.
2. Ofruesi i shërbimeve të pagesave të paguesit zhbllok fondet e bllokuara në llogarinë e pagesës së paguesit, sipas pikës 1, të këtij neni, pa vonesë, pas marrjes së informacionit lidhur me shumën e saktë të transaksionit të pagesës apo të paktën menjëherë pas marrjes së urdhërpagesës.

Neni 69

Rimbursimet për transaksionet e pagesës të iniciuara nga ose nëpërmjet një përfituesi pagese

1. Paguesi ka të drejtë të përfitojë një rimbursim nga ofruesi i tij i shërbimeve të pagesave për një transaksion pagese të autorizuar, i cili është iniciuar nga/ose nëpërmjet një përfituesi pagese dhe është ekzekutuar tashmë, nëse plotësohen të dyja kushtet e mëposhtme:
 - a) në autorizim nuk cilësohej shuma e saktë e transaksionit të pagesës në

momentin e dhënies së autorizimit;

- b) shuma e transaksionit të pagesës tejkalonte shumën e parashikuar në mënyrë të arsyeshme nga paguesi, duke marrë parasysh shpenzimet e mëparshme të pritshme, kushtet e kontratës tip dhe rrethanat përkatëse të rastit.
2. Me kërkesën e ofruesit të shërbimeve të pagesave, paguesi ka detyrimin të provojë se kushtet, sipas pikës 1, të këtij neni, janë plotësuar.
 3. Rimbursimi sipas pikës 1, të këtij neni, kryhet në shumën e plotë të transaksionit të pagesës të ekzekutuar. Datëvaluta e kreditimit të llogarisë së pagesës të paguesit nuk duhet të jetë më vonë se data kur shuma ishte debituar.
 4. Në rastin e debitimeve direkte, pa rënë ndesh me pikën 6, të këtij neni, dhe krahas të drejtës për rimbursim të përcaktuar në pikën 1, të këtij neni, paguesi ka të drejtë të pakushtëzuar për rimbursim, brenda afateve kohore të përcaktuara në nenin 70, të këtij ligji.
 5. Pavarësisht nga pika 4, e këtij neni, për qëllime të shkronjës “b”, të pikës 1, të këtij neni, paguesi nuk mund të përdorë si justifikim kursin e këmbimit valutor, nëse është aplikuar kursi i këmbimit referencë për të cilin kanë rënë dakord me ofruesin e shërbimeve të pagesave, sipas shkronjës “ç”, të pikës 1, të nenit 38, dhe nënndarjes “ii”, të shkronjës “c”, të nenit 45, të këtij ligji.
 6. Në kontratën tip ndërmjet paguesit dhe ofruesit të shërbimeve të pagesave mund të bihet dakord që paguesi nuk ka të drejtën për rimbursim, kur:
 - a) paguesi ka dhënë pëlqimin e tij për ekzekutimin e transaksionit të pagesës drejtpërdrejt tek ofruesi i shërbimeve të pagesave; dhe
 - b) aty ku është e zbatueshme, paguesit i është dhënë ose i është vënë në dispozicion nga ofruesi i shërbimeve të pagesave apo nga përfituesi i pagesës, të paktën katër javë përpara datës së pagesës dhe sipas mënyrës së rënë dakord, informacioni mbi transaksionin e pagesës që do të kryhet në të ardhmen.
 7. Për debitime direkte në monedha të tjera, përveç monedhës kombëtare “lekë”, Banka e Shqipërisë mund krijojë të drejta rimbursimi, përveç atyre të parashikuara në këtë nen, me kusht që ato të jenë më të favorshme për paguesin.

Neni 70

Kërkesat për rimbursime për transaksione pagesë të iniciuara nga ose nëpërmjet një përfituesi pagesë

1. Paguesi mund të kërkojë rimbursimin, sipas nenit 69, të këtij ligji, të një transaksioni të autorizuar pagese të iniciuar nga ose nëpërmjet një përfituesi pagese brenda 8 (tetë) javësh nga data në të cilën janë debituar fondet.
2. Ofruesi i shërbimeve të pagesave, brenda dhjetë ditësh pune nga marrja e kërkesës për rimbursim, kthen shumën e plotë të transaksionit të pagesës ose jep arsyet për refuzimin e rimbursimit, si dhe cilëson organet përkatëse ku pagesi mund të ankimojë, në përputhje me nenet 92 e 93, të këtij ligji, në qoftë se ai nuk i pranon arsyet e dhëna.
3. E drejta e ofruesit të shërbimeve të pagesave për të refuzuar rimbursimin, sipas pikës 2, të këtij neni, nuk zbatohet në rastin e debitimit direkt.

KREU III

EKZEKUTIMI I TRANSAKSIONEVE TË PAGESËS

Seksioni 1

Urdhërpagesat dhe shumat e transferuara

Neni 71

Marrja e urdhërpagesave

1. Koha e marrjes së urdhërpagesës është momenti kur ofruesi i shërbimeve të pagesave të paguesit merr urdhërpagesën.
2. Llogaria e paguesit nuk debitohet përpara marrjes së urdhërpagesës. Nëse koha e marrjes nuk përkon me një ditë pune për ofruesin e shërbimeve të pagesave të paguesit, urdhërpagesa konsiderohet si e marrë në dorëzim në ditën pasardhëse të punës. Ofruesi i shërbimeve të pagesave mund të caktojë një orar kufi pranë përfundimit të një dite pune (*cut-off*), përtej të cilit çdo urdhërpagesë e marrë konsiderohet si e marrë në ditën pasardhëse të punës.
3. Nëse përdoruesi i shërbimeve të pagesave që inicion një urdhërpagesë dhe ofruesi i shërbimeve të pagesave bien dakord që ekzekutimi i urdhërpagesës të fillojë në një ditë të caktuar, ose në fund të një periudhe të caktuar, ose në ditën në të cilën pagesi vendos fondet e nevojshme në dispozicion të ofruesit të shërbimeve të pagesave, koha e marrjes së urdhërpagesës, për qëllime të nenit 76, të këtij ligji, është dita e rënë dakord ndrmjet tyre. Nëse dita e rënë dakord nuk është ditë pune për ofruesin e shërbimeve të pagesave, urdhërpagesa konsiderohet e marrë në ditën pasardhëse të punës.

Neni 72

Refuzimi i urdhërpagesave

1. Kur ofruesi i shërbimeve të pagesave refuzon të ekzekutojë një urdhërpagesë ose të iniciojë një transaksion pagese, refuzimi dhe, nëse është e mundur, arsyet për të, si dhe procedura për korrigjimin e ndonjë gabimi faktik që çojnë në refuzim, i njoftohen përdoruesit të shërbimeve të pagesave, me përjashtim të rasteve kur ndalohet nga legjislacioni në fuqi.
2. Ofruesi i shërbimeve të pagesave jep ose vë në dispozicion njoftimin në mënyrën e rënë dakord në rastin më të parë të mundur, dhe, në çdo rast, brenda afateve të përcaktuara në nenin 76, të këtij ligji.
3. Kontrata tip mund të përmbajë një kusht që ofruesi i shërbimeve të pagesave të aplikojë një tarifë të arsyeshme për refuzimin sipas pikës 1, të këtij neni, në qoftë se ka arsye objektive për refuzimin.
4. Në rastet kur të gjitha kushtet e përcaktuara në kontratën tip të paguesit janë plotësuar, ofruesi i shërbimit të pagesës për shërbimin e llogarisë të paguesit nuk refuzon ekzekutimin e një urdhërpagese të autorizuar, pavarësisht nëse urdhërpagesa iniciohet nga një pagues, përfshirë këtu dhe iniciimin me anë të një ofruesi të shërbimit të iniciimit të pagesës ose nëpërmjet përfituesit të pagesës, përveçse kur është e ndaluar nga legjislacioni në fuqi.
5. Për qëllimet e neneve 76 e 82, të këtij ligji, urdhërpagesa, së cilës i është refuzuar ekzekutimi, konsiderohet e pamarrë.

Neni 73

Parevokueshmëria e urdhërpagesës

1. Përdoruesi i shërbimeve të pagesave nuk revokon urdhërpagesën, pasi merret nga ofruesi i shërbimeve të pagesave të paguesit, me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë nen.
2. Kur transaksioni i pagesës është iniciuar nga ofruesi i shërbimit të iniciimit të pagesës apo nga ose nëpërmjet përfituesit të pagesës, paguesi nuk mund të revokojë urdhërpagesën pas dhënies së pëlqimit për ta iniciuar transaksionin e pagesës tek ofruesi i shërbimit të iniciimit të pagesës ose pasi ka dhënë pëlqimin për ta ekzekutuar transaksionin e pagesës te përfituesi i pagesës.
3. Pavarësisht pikës 2, të këtij neni, në rastin e një debitimi direkt dhe pa cenuar të drejtat për rimbursim, paguesi mund të revokojë urdhërpagesën jo më vonë se fundi i ditës së punës që i paraprin ditës së rënë dakord për debitimin e fondeve.
4. Në rastin e parashikuar në pikën 2, të nenit 71, të këtij ligji, përdoruesi i shërbimeve të pagesave mund të revokojë urdhërpagesën jo më vonë se

fundi i ditës së punës që i paraprin ditës së rënë dakord.

5. Pas afateve kohore të përcaktuara në pikat 1 deri në 4, të këtij neni, urdhërpagesa mund të revokohet vetëm nëse përdoruesi i shërbimeve të pagesave dhe ofruesit përkatës të shërbimeve të pagesave bien dakord ndërmjet tyre. Në rastet e parashikuara në pikat 2 dhe 3, të këtij neni, kërkohet dhe dakordësia e përfituesit të pagesës. Ofruesi përkatës i shërbimeve të pagesave mund të aplikojë tarifa për revokimin, nëse është parashikuar në kontratën tip.

Neni 74

Shumat e transferuara dhe shumat e marra

1. Ofruesi i shërbimeve të pagesave të paguesit, ofruesi i shërbimeve të pagesave të përfituesit të pagesës, si dhe çdo ndërmjetës i ofruesve të shërbimeve të pagesave transferon shumën e plotë të transaksionit të pagesës dhe shmang zbritjen e tarifave nga shuma e transferuar.
2. Pavarësisht pikës 1, të këtij neni, përfituesi i pagesës dhe ofruesi i shërbimeve të pagesave mund të bien dakord që ofruesi përkatës i shërbimeve të pagesave të zbresë tarifën e tij nga shuma e transferuar para se ta kreditojë atë tek përfituesi i pagesës. Në një rast të tillë, shuma e plotë e transaksionit të pagesës dhe ajo e tarifave duhet të jepen të ndara në informacionin që i jepet përfituesit të pagesës.
3. Nëse nga shuma e transferuar duhet të zbriten tarifa të tjera, përveç atyre të përmendura në pikën 2, të këtij neni, ofruesi i shërbimeve të pagesave të paguesit siguron që përfituesi i pagesës të marrë shumën e plotë të transaksionit të pagesës të iniciuar nga paguesi. Në rastet kur transaksioni i pagesës është iniciuar nga, ose nëpërmjet, përfituesit të pagesës, ofruesi i tij i shërbimeve të pagesave siguron që përfituesi i pagesës të marrë shumën e plotë të transaksionit të pagesës.

Seksioni 2

Koha e ekzekutimit dhe datëvaluta

Neni 75

Fusha e zbatimit

1. Ky seksion zbatohet për:
 - a) transaksionet e pagesave në monedhën kombëtare “lekë”;

- b) transaksionet e pagesave kombëtare në “euro”.
2. Ky seksion zbatohet për transaksionet e pagesave, të cilat nuk përmenden në pikën 1, të këtij neni, me përjashtim të rasteve kur është rënë dakord ndryshe ndërmjet përdoruesit të shërbimeve të pagesave dhe ofruesit të shërbimeve të pagesave. Në çdo rast do të zbatohet parashikimi i nenit 79, të këtij ligji.
 3. Për transaksionet e pagesave ndërkufitare me shtetet anëtare të Bashkimit Evropian, përdoruesi i shërbimeve të pagesave dhe ofruesi i shërbimeve të pagesave bien dakord për një periudhë më të gjatë se ajo e përcaktuar në nenin 76, të këtij ligji, e cila nuk tejkalon 4 (katër) ditë pune pas datës së marrjes së urdhërpagesës, sipas nenit 71, të këtij ligji.

Neni 76

Transaksionet e pagesës në një llogari pagese

1. Ofruesi i shërbimeve të pagesave të paguesit siguron që, pas datës së marrjes së urdhërpagesës, sipas nenit 71, të këtij ligji, shuma e transaksionit të pagesës të kreditohet në llogarinë e ofruesit të shërbimeve të pagesave të përfituesit të pagesës jo më vonë se fundi i ditës pasardhëse të punës. Ky afat mund të zgjatet me një ditë pune shtesë për transaksionet e pagesave të iniciuara në format *hard copy*.
2. Ofruesi i shërbimeve të pagesave të përfituesit të pagesës përcakton datëvalutën dhe kalon shumën e transaksionit të pagesës në llogarinë e pagesës së përfituesit, pasi ofruesi i shërbimeve të pagesave të ketë marrë fondet, sipas nenit 79, të këtij ligji.
3. Ofruesi i shërbimeve të pagesave të përfituesit të pagesës transmeton një urdhërpagesë të iniciuar nga ose nëpërmjet përfituesit të pagesës tek ofruesi i shërbimeve të pagesave të paguesit brenda afateve të rëna dakord ndërmjet palëve, duke bërë të mundur shlyerjen, për sa i përket debitimit direkt, në datën e rënë dakord për pagesën.

Neni 77

Mungesa e një llogarie pagese të përfituesit të pagesës, pranë ofruesit të shërbimeve të pagesave

Kur përfituesi i pagesës nuk ka llogari pagese pranë ofruesit të shërbimeve të pagesave, fondet vihen në dispozicion të përfituesit të pagesës nga ofruesi i shërbimeve të pagesave, i cili merr fondet për përfituesin e pagesës brenda periudhës të përcaktuar në nenin 76, të këtij ligji.

Neni 78

Paraja fizike (cash-i) e vendosur në një llogari pagese

Kur një konsumator ose një mikrondërmarrje vendos para fizike (*cash*) në llogarinë e pagesave që ka me ofruesin e shërbimeve të pagesave në monedhën në të cilën mbahet llogaria e pagesës, ofruesi i shërbimeve të pagesave siguron që shuma të vihet në dispozicion dhe të bëhet efektive menjëherë pas momentit të marrjes së fondeve. Kur përdoruesi i shërbimeve të pagesave nuk është konsumator ose mikrondërmarrje, shuma vihet në dispozicion dhe bëhet efektive jo më vonë se në ditën pasardhëse të punës pas marrjes së fondeve.

Neni 79

Datëvaluta dhe disponueshmëria e fondeve

1. Datëvaluta e kreditimit të llogarisë së pagesës së përfituesit të pagesës nuk duhet të jetë më vonë se dita e punës, në të cilën shuma e transaksionit të pagesës është kredituar në llogarinë e ofruesit të shërbimeve të pagesave të përfituesit të pagesës.
2. Ofruesi i shërbimeve të pagesave të përfituesit të pagesës siguron që shuma e transaksionit të pagesës është në dispozicion të përfituesit menjëherë pasi kjo shumë të jetë kredituar në llogarinë e ofruesit të shërbimeve të pagesave të përfituesit, kur nga ana e ofruesit të shërbimeve të pagesave të paguesit nuk ka këmbim të monedhës.
3. Detyrimi sipas pikës 2, të këtij neni, zbatohet edhe për pagesat brenda të njëjtit ofrues të shërbimeve të pagesave.
4. Datëvaluta e debitimit të llogarisë të pagesës së paguesit është jo më herët se momenti në të cilin shuma e transaksionit të pagesës debitohet në llogarinë e pagesës.

Neni 80

Transaksionet kombëtare të pagesave

Për transaksionet kombëtare të pagesave, Banka e Shqipërisë, me akt nënligjor, mund të parashikojë një afat maksimal ekzekutimi më të shkurtër se afatet e parashikuara në këtë seksion.

Seksioni 3

Detyrimi

Neni 81

Kodi unik i identifikimit i pasaktë

1. Në rastin kur urdhërpagesa është ekzekutuar në përputhje me kodin unik të identifikimit, urdhërpagesa konsiderohet se është ekzekutuar saktësisht për përfituesin e pagesës të përcaktuar nga kodi unik i identifikimit.
2. Në rastin kur kodi unik i identifikimit i dhënë nga përdoruesi i shërbimeve të pagesave është i pasaktë, ofruesi i shërbimeve të pagesave nuk është përgjegjës sipas nenit 82, të këtij ligji, për mosekzekutimin ose ekzekutimin e gabuar të transaksionit të pagesës.
3. Pavarësisht pikës 2, të këtij neni, ofruesi i shërbimeve të pagesave të paguesit bën përpjekje të arsyeshme për të rikuperuar fondet e përfshira në transaksionin e pagesës. Ofruesi i shërbimeve të pagesave të përfituesit të pagesës gjithashtu bashkëpunon në këto përpjekje, duke i komunikuar ofruesit të shërbimeve të pagesave të paguesit të gjithë informacionin në dispozicion për mbledhjen e fondeve.
4. Në rast se mbledhja e fondeve sipas pikës 3, të këtij neni, nuk është e mundur, ofruesi i shërbimeve të pagesave të paguesit i siguron paguesit, pas një kërkesë me shkrim, të gjithë informacionin në dispozicion të ofruesit të shërbimeve të pagesave të paguesit dhe që paraqet interes për paguesin, me qëllim paraqitjen e një ankese ligjore për të rikuperuar fondet.
5. Nëse është rënë dakord në kontratën tip, ofruesi i shërbimeve të pagesave mund të tarifojë përdoruesin e shërbimeve të pagesave për rimbursimin e fondeve.
6. Ofruesi i shërbimeve të pagesave është përgjegjës vetëm për ekzekutimin e transaksioneve të pagesës sipas kodit unik të identifikimit të dhënë nga përdoruesi i shërbimeve të pagesave, pavarësisht nëse përdoruesi i shërbimeve të pagesave jep informacion shtesë veç atij që specifikohet në shkronjën “a”, të pikës 1, të nenit 38, ose në nënndarjen “ii”, të shkronjës “b”, të nenit 45, të këtij ligji.

Neni 82

Përgjegjësia e ofruesit të shërbimeve të pagesave për mosekzekutimin, ekzekutimin e gabuar ose me vonesë të transaksioneve të pagesave

1. Kur urdhërpagesa është iniciuar drejtpërdrejt nga paguesi:
 - a) ofruesi i shërbimeve të pagesave të paguesit, pa cenuar nenet 64, 81,

pikat 2, 3 dhe 4, e 86, të këtij ligji, është përgjegjës ndaj paguesit për ekzekutimin e saktë të transaksionit të pagesës, përveçse kur ai mund t'i provojë paguesit dhe, aty kur është rasti, ofruesit të shërbimeve të pagesave të përfituesit të pagesës që ofruesi i shërbimeve të pagesave të përfituesit të pagesës ka marrë shumën e transaksionit të pagesës, sipas pikës 1, të nenit 76, të këtij ligji. Në këtë rast ofruesi i shërbimeve të pagesave i përfituesit të pagesës është përgjegjës ndaj përfituesit të pagesës për ekzekutimin e saktë të transaksionit të pagesës;

- b) kur ofruesi i shërbimeve të pagesave të paguesit është përgjegjës sipas shkronjës “a”, të pikës 1, të këtij neni, ai i rimbursen paguesit, pa vonesa të panevojshme, shumën e transaksionit të pagesës së paekzekutuar apo të kryer gabimisht dhe, kur është rasti, rikthen llogarinë e debituar të pagesës në gjendjen në të cilën do të kishte qenë nëse transaksioni i gabuar i pagesës nuk do të kishte ndodhur;
- c) datëvaluta e kreditimit për llogarinë e pagesës të paguesit nuk duhet të kalojë datën kur shuma është debituar;
- ç) kur ofruesi i shërbimeve të pagesave të përfituesit të pagesës është përgjegjës sipas shkronjës “a”, të pikës 1, të këtij neni, menjëherë vendos shumën e transaksionit të pagesës në dispozicion të përfituesit të pagesës dhe, kur është e aplikueshme, krediton shumën korresponduese në llogarinë e pagesës së përfituesit të pagesës;
- d) datëvaluta e kreditimit për llogarinë e pagesës së përfituesit të pagesës duhet të jetë jo më vonë se data në të cilën shuma do të kishte datëvalutën, nëse transaksioni i pagesës do të ishte kryer në mënyrë korrekte sipas nenit 79, të këtij ligji;
- dh) kur transaksioni i pagesës kryhet me vonesë, ofruesi i shërbimeve të pagesave të përfituesit të pagesës siguron, me kërkesë të ofruesit të shërbimeve të pagesave të paguesit që vepron në emër të paguesit, që datëvaluta e kreditimit për llogari të pagesës së përfituesit të jetë jo më vonë se data kur shuma do të kishte marrë datëvalutën nëse transaksioni do të ishte kryer në mënyrë korrekte;
- e) në rast të një transaksioni pagese të paekzekutuar apo të ekzekutuar në mënyrë jo të rregullt, ofruesi i shërbimeve të pagesave të paguesit, pavarësisht përgjegjësisë sipas kësaj pike, me kërkesë të paguesit dhe pa aplikuar tarifa, bën përpjekje të menjëhershme për të ndjekur transaksionin e pagesës dhe njofton paguesin për rezultatin.

2. Kur urdhërpagesa inicohet nga ose nëpërmjet përfituesit të pagesës:

- a) ofruesi i tij i shërbimeve të pagesave, pa rënë ndesh me nenet 64, 81, pikat 2, 3 dhe 4, e 86, të këtij ligji, është përgjegjës ndaj përfituesit të pagesës për transmetimin e saktë të urdhërpagesës tek ofruesi i shërbimeve të pagesave të paguesit, sipas pikës 3, të nenit 76, të këtij ligji. Kur ofruesi i shërbimeve të pagesave të përfituesit është përgjegjës

sipas kësaj shkronje, ai duhet ta ridërgojë menjëherë urdhërpagesën në fjalë tek ofruesi i shërbimeve të pagesave të paguesit;

- b) në rast transmetimi të vonuar të urdhërpagesës, shuma merr datëvalutën në llogari të pagesës së përfituesit të pagesës jo më vonë se data në të cilën shuma do të kishte marrë datëvalutë nëse transaksioni do të ishte kryer në mënyrë korrekte;
- c) përveç kësaj, ofruesi i shërbimeve të pagesave të përfituesit, pa rënë ndesh me nenet 64, 81, pikat 2, 3 dhe 4, e 86, të këtij ligji, është përgjegjës ndaj përfituesit të pagesës për trajtimin e transaksionit të pagesës në përputhje me detyrimet e tij, sipas nenit 79, të këtij ligji;
- ç) kur ofruesi i shërbimeve të pagesave të përfituesit të pagesës është përgjegjës sipas shkronjës “c”, të kësaj pike, ai siguron që shuma e transaksionit të pagesës të jetë në dispozicion të përfituesit të pagesës, menjëherë pasi ajo shumë të jetë kredituar në llogarinë e ofruesit të shërbimeve të pagesave të përfituesit të pagesës. Shuma merr datëvalutë në llogari të pagesës së përfituesit të pagesës jo më vonë se data kur shuma do të kishte marrë datëvalutë nëse transaksioni do të ishte kryer në mënyrë korrekte;
- d) në rastin e një transaksioni të paekzekutuar apo të ekzekutuar në mënyrë jo të rregullt, për të cilin ofruesi i shërbimeve të pagesave të përfituesit të pagesës nuk është përgjegjës sipas shkronjave “a” dhe “b”, të pikës 2, të këtij neni, ofruesi i shërbimeve të pagesave të paguesit do të jetë përgjegjës për paguesin. Kur ofruesi i shërbimeve të pagesave të paguesit është përgjegjës, ai, sipas mundësisë dhe pa vonesa, i rimbursen paguesit, shumën e transaksionit të pagesës së paekzekutuar apo të kryer gabimisht dhe rikthen llogarinë e debituar të pagesës në gjendjen në të cilën do të kishte qenë nëse transaksioni i gabuar i pagesës nuk do të kishte ndodhur. Datëvaluta e kreditimit për llogarinë e pagesës të paguesit nuk duhet të jetë më vonë se data kur shuma ishte debituar;
- dh) detyrimi sipas shkronjës “d”, të kësaj pike, nuk aplikohet për ofruesin e shërbimeve të pagesave të paguesit në rast se ofruesi i shërbimeve të pagesave të paguesit vërteton që ofruesi i shërbimeve të pagesave të përfituesit të pagesës ka marrë shumën e transaksionit të pagesës, edhe kur ekzekutimi i transaksionit të pagesës thjesht është vonuar. Në një rast të tillë, ofruesi i shërbimeve të pagesave të përfituesit të pagesës vendos shumën në llogari të pagesës së përfituesit të pagesës me datëvalutë jo më vonë se datëvaluta që do të kishte marrë shuma nëse transaksioni do të ishte kryer në mënyrë korrekte;
- e) në rast të një transaksioni pagese të paekzekutuar apo të ekzekutuar në mënyrë jo të rregullt, kur urdhërpagesa është iniciuar nga përfituesi i pagesës, ofruesi i shërbimeve të pagesave të përfituesit të pagesës pavarësisht përgjegjësisë sipas kësaj shkronje, me kërkesë të përfituesit dhe pa aplikuar tarifa, bën përpjekje të menjëhershme për të ndjekur transaksionin e pagesës dhe njofton përfituesin e pagesës për rezultatin.

3. Përveç sa më sipër, ofruesit e shërbimeve të pagesave janë përgjegjës ndaj përdoruesve të tyre të shërbimeve të pagesave për çdo tarifë e për çdo interes që përdoruesi i shërbimeve të pagesave është subjekt si pasojë e mosekzekutimit ose ekzekutimit të gabuar, duke përfshirë edhe ekzekutimet me vonesë të transaksionit të pagesës.

Neni 83

Përgjegjësia në rastin e shërbimit të iniciimit të pagesës për mosekzekutimin, ekzekutimin e gabuar apo me vonesë të transaksioneve të pagesës

1. Kur urdhërpagesa është iniciuar nga një pagues nëpërmjet një ofruesi të shërbimit të iniciimit të pagesës, ofruesi i shërbimit të pagesës për shërbimin e llogarisë, pa rënë ndesh me nenet 64 e 81, pikat 2, 3 dhe 4, të këtij ligji, i rimbursen paguesit shumën e transaksionit të pagesës së paekzekutuar ose të ekzekutuar gabim dhe, kur është e zbatueshme, rikthen llogarinë e pagesës të debituar në gjendjen në të cilën do të kishte qenë nëse transaksioni i gabuar nuk do të kishte ndodhur.
2. Barra e provës është e ofruesit të shërbimit të iniciimit të pagesës për të vërtetuar se urdhërpagesa është marrë nga ofruesi i shërbimit të pagesës për shërbimin e llogarisë të paguesit, në përputhje me nenin 71, të këtij ligji, dhe se, brenda fushës së kompetencave të tij, transaksioni i pagesës është autentifikuar, regjistruar me saktësi dhe nuk është ndikuar nga defekte teknike apo mangësi të tjera të lidhura me mosekzekutimin, ekzekutimin e gabuar apo të vonuar të transaksionit.
3. Nëse ofruesi i shërbimit të iniciimit të pagesës është përgjegjës për mosekzekutimin, ekzekutimin e gabuar apo me vonesë të transaksionit të pagesës, ai menjëherë kompenson ofruesin e shërbimit të pagesës për shërbimin e llogarisë, me kërkesë të tij, për humbjet e shkaktuara apo shumat e paguara si pasojë e rimbursimit të paguesit.

Neni 84

Kompensim financiar shtesë

Ky seksion nuk cenon asnjë kompensim financiar shtesë të përcaktuar sipas legjislacionit në fuqi për kontratat e nënshkruara ndërmjet përdoruesit dhe ofruesit të shërbimeve të pagesave.

Neni 85

E drejta e kompensimit

1. Kur përgjegjësia e një ofruesi të shërbimeve të pagesave sipas neneve 66 e 82, të këtij ligji, i atribuohet një tjetër ofruesi të shërbimeve të pagesave ose një ndërmjetësi, ky ofrues i shërbimeve të pagesave apo ndërmjetës kompenson ofruesin e parë të shërbimeve të pagesave për çdo humbje të shkaktuar apo për shumat e paguara sipas neneve 66 e 82, të këtij ligji. Kjo përfshin kompensimin, kur ndonjë nga ofruesit e shërbimeve të pagesave dështon të përdorë autentifikim të thelluar të klientit.
2. Kompensim financiar shtesë mund të përcaktohet në përputhje me marrëveshjet ndërmjet ofruesve të shërbimeve të pagesave dhe/ose ndërmjetësve dhe ligjit të zbatueshëm që rregullon marrëveshjen e nënshkruar midis tyre.

Neni 86

Rrethana të jashtëzakonshme dhe të paparashikueshme

Asnjë përgjegjësi nuk mund të lindë sipas krerëve II e III, të këtij titulli, në rastet e rrethanave të jashtëzakonshme e të paparashikueshme jashtë kontrollit të palës që ka kërkuar zbatimin e këtyre rrethanave, pasojat e të cilave do të ishin të pashmangshme, pavarësisht të gjitha përpjekjeve për të kundërtën apo në rastet kur një ofrues i shërbimeve të pagesave u nënshtrohet detyrimeve të tjera të përcaktuara në akte të tjera ligjore ose nënligjore.

KREU IV

MBROJTJA E TË DHËNAVE PERSONALE

Neni 87

Mbrojtja dhe përpunimi i të dhënave personale

1. Sistemet e pagesave dhe ofruesit e shërbimeve të pagesave përpunojnë të dhëna personale kur është e nevojshme dhe në masën e nevojshme për të mbrojtur parandalimin, hetimin e zbulimin e mashtrimit të pagesës. Përpunimi i të dhënave personale për qëllime të këtij ligji kryhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.
2. Ofruesit e shërbimeve të pagesave aksesojnë, përpunojnë dhe mbajnë të dhëna personale të nevojshme për ofrimin e shërbimeve të tyre të pagesave, me pëlqimin e shprehur qartazi të përdoruesit të shërbimeve të pagesave.

KREU V

RREZIQET OPERACIONALE DHE TË SIGURISË DHE AUTENTIFIKIMI

Neni 88

Administrimi i rreziqeve operacionale dhe të sigurisë

1. Ofruesit e shërbimeve të pagesave krijojnë një kuadër rregullativ me masat e duhura zbutëse dhe mekanizma kontrolli për administrimin e rreziqeve operacionale dhe të sigurisë, të lidhura me shërbimet e pagesave të ofruara prej tyre. Si pjesë e këtij kuadri rregullativ, ofruesi i shërbimeve të pagesave krijon dhe mban procedura efektive të administrimit të incidentit, përfshirë edhe ato për zbulimin dhe klasifikimin e incidenteve të mëdha operacionale e të sigurisë.
2. Ofruesit e shërbimeve të pagesave i vënë në dispozicion Bankës së Shqipërisë, në bazë vjetore ose dhe në intervale më të shkurtra kohore të përcaktuara nga Banka e Shqipërisë, një vlerësim të përditësuar e gjithëpërfshirës të rrezikut operacional dhe atij të sigurisë lidhur me shërbimet e pagesave që ata ofrojnë dhe mbi përshtatshmërinë e masave zbutëse e të mekanizmave të kontrollit të zbatuara në përgjigje të atyre rreziqeve.
3. Banka e Shqipërisë nxjerr akte nënligjore në zbatim të kërkesave të këtij neni, mbështetur në praktikat më të mira ndërkombëtare dhe në standardet teknike rregullatore të fushës.

Neni 89

Raportimi i incidenteve

1. Në rast se ndodh një incident madhor operacional apo i sigurisë, ofruesit e shërbimeve të pagesave njoftojnë pa vonesa të pajustificuara Bankën e Shqipërisë.
2. Në rastet kur incidenti ka ose mund të ketë ndikim në interesat financiarë të përdoruesve të tij të shërbimeve të pagesave, ofruesi i shërbimeve të pagesave informon pa vonesa të pajustificuara përdoruesit e tij të shërbimeve të pagesave për incidentin e për të gjitha masat që ata mund të marrin për të zbutur efektet e padëshiruara të incidentit.
3. Pas marrjes së njoftimit sipas pikës 1, të këtij neni, Banka e Shqipërisë, kur është e përshtatshme, merr të gjitha masat e nevojshme për të mbrojtur sigurinë e menjëhershme të sistemit financiar.
4. Ofruesit e shërbimeve të pagesave sigurojnë të dhëna statistikore për mashtrimet lidhur me mjetet e ndryshme të pagesës dhe i raportojnë këto të dhëna në Bankën e Shqipërisë, të paktën në baza vjetore.

Neni 90

Autentifikimi

1. Ofruesit e shërbimeve të pagesave, sipas mënyrës së përcaktuar nga Banka e Shqipërisë, zbatojnë autentifikim të thelluar të klientit në rastet kur paguesi:
 - a) akseson llogarinë e tij të pagesave *on-line*;
 - b) inicion një transaksion elektronik pagese;
 - c) kryen çdo veprim nëpërmjet një mënyre komunikimi në distancë, që mund të përfshijë rrezik mashtrimi pagese apo abuzime të tjera.
2. Në rastet e iniciimit të transaksioneve të pagesave elektronike, sipas shkronjës “b”, të pikës 1, të këtij neni, për transaksionet e pagesave elektronike në distancë, ofruesit e shërbimeve të pagesave zbatojnë autentifikim të thelluar të klientit, i cili përfshin elemente që në mënyrë dinamike lidhin transaksionin me një shumë të caktuar e me një përfitues të caktuar pagese.
3. Ofruesit e shërbimit të pagesave marrin masat e duhura të sigurisë për të mbrojtur konfidencialitetin dhe integritetin e kredencialeve të personalizuar të sigurisë së përdoruesve të shërbimit të pagesave, në zbatim të pikës 1, të këtij neni.
4. Pikat 2 e 3, të këtij neni, zbatohen edhe në rastet kur pagesat janë iniciuar nëpërmjet një ofruesi të shërbimit të iniciimit të pagesave. Pikat 1 dhe 3, të këtij neni, zbatohen në rastet kur informacioni kërkohet nëpërmjet një ofruesi të shërbimit të informimit të llogarisë.
5. Ofruesi i shërbimit të pagesës për shërbimin e llogarisë i lejon ofruesit të shërbimit të iniciimit të pagesës dhe ofruesit të shërbimit të informimit të llogarisë të mbështeten te procedurat e autentifikimit të ofruara nga ofruesit e shërbimit të pagesës për shërbimin e llogarisë të përdoruesi i shërbimeve të pagesave në përputhje me pikat 1 e 3, të këtij neni, në rastet kur përfshihet ofruesi i shërbimit të iniciimit të pagesës sipas pikave 1, 2 e 3, të këtij neni.

Neni 91

Kërkesat teknike për autentifikimin dhe komunikimin

1. Banka e Shqipërisë përcakton me akt nënligjor kërkesat teknike për ofruesit e shërbimeve të pagesave, siç përcaktohet në pikën 29, të nenit 5, të këtij ligji, duke specifikuar:

- a) kërkesat për autentifikim të thelluar të klientit, sipas pikave 1 e 2, të nenit 90, të këtij ligji;
 - b) përjashtimet nga zbatimi i pikave 1, 2 e 3, të nenit 90, të këtij ligji, bazuar në kriteret e përcaktuara në pikën 3, të këtij neni;
 - c) kërkesat me të cilat masat e sigurisë duhet të jenë në përputhje, sipas pikës 3, të nenit 90, të këtij ligji, për të mbrojtur konfidencialitetin dhe integritetin e kredencialeve të personalizuar të sigurisë së përdoruesve të shërbimeve të pagesave; dhe
 - ç) kërkesat për standarde komunikimi të përbashkëta dhe të hapura me qëllim identifikimin, autentifikimin, njoftimin e dhënien e informacionit, si dhe për zbatimin e masave të sigurisë, ndërmjet ofruesve të shërbimit të pagesës për shërbimin e llogarisë, ofruesve të shërbimit të iniciimit të pagesës, paguesve, përfituesve të pagesës dhe ofruesve të shërbimeve të tjera të pagesave.
2. Banka e Shqipërisë përcakton me akt nënligjor kërkesat teknike, sipas pikës 1, të këtij neni, në mënyrë të tillë që:
- a) të sigurojë një nivel të përshtatshëm sigurie për përdoruesit e shërbimeve të pagesave dhe të ofruesve të shërbimeve të pagesave, nëpërmjet miratimit të kërkesave efektive dhe të bazuara në rrezik;
 - b) të garantojë sigurinë e fondeve dhe të të dhënave personale të përdoruesve të shërbimeve të pagesave;
 - c) të sigurojë dhe të ruajë një konkurrencë të drejtë e të sigurt mes ofruesve të shërbimeve të pagesave;
 - d) të sigurojë neutralitet të modelit të biznesit e të teknologjisë;
 - e) të lejojë zhvillimin e mënyrave të pagesës lehtësisht të përdorshme, të aksesueshme e novatore.
3. Përjashtimet e përmendura në shkronjën “b”, të pikës 1, të këtij neni, bazohen në kriteret e mëposhtme:
- a) nivelin e rrezikut të përfshirë në shërbimin e ofruar;
 - b) shumën, karakterin përsëritës të transaksionit ose të dyja;
 - c) mënyrën e pagesës së përdorur për kryerjen e transaksionit.

KREU VI

PROCEDURAT PËR ZGJIDHJEN ALTERNATIVE TË MOSMARRËVESHJEVE

Neni 92

Njësia përgjegjëse për zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve (ZAM)

1. Banka e Shqipërisë, pa paragjykuar të drejtën e palëve për t'iu drejtuar gjykatës, në bazë të legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e konsumatorit, krijon një njësi të veçantë ZAM, e cila shqyrton dhe zgjidh mosmarrëveshjet e lindura ndërmjet konsumatorëve ose mikrondërmarrjeve dhe ofruesve të shërbimeve të pagesave për shkelje të pretenduara të këtij ligji nga ana e ofruesve të shërbimeve të pagesave.
2. Banka e Shqipërisë, me akt nënligjor, miraton rregullat për funksionimin dhe organizimin e njësisë ZAM, në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e konsumatorit.
3. Banka e Shqipërisë, me akt nënligjor, miraton procedurat për zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve nga ana e njësisë ZAM, në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e konsumatorit. Procedurat për zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve ndërmjet palëve të përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, lidhur me të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga titujt III e IV, të këtij ligji, duhet të jenë të përshtatshme, të pavarura, të paanshme, transparente dhe efektive.
4. Procedurat e ZAM-së, sipas pikës 3, të këtij neni, zbatohen për ofruesit e shërbimeve të pagesave dhe gjithashtu mbulojnë edhe veprimtaritë e personave që administrojnë biznesin.
5. Banka e Shqipërisë publikon procedurat për zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve.

Neni 93

Detyrimet e ofruesve të shërbimeve të pagesave për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve

1. Konsumatorët ose mikrondërmarrjet, përpara se të paraqesin ankim pranë njësisë ZAM, i drejtohen ofruesit të shërbimeve të pagesave për shkelje të pretenduara të këtij ligji.
2. Ofruesit e shërbimeve të pagesave, si subjekte të mbikëqyrura dhe të rregulluara nga Banka e Shqipërisë, krijojnë e zbatojnë procedura të përshtatshme dhe efektive për zgjidhjen e ankesave lidhur me të drejtat e detyrimet që rrjedhin nga titujt III e IV, të këtij ligji.
3. Procedurat e cituara në pikën 2, të këtij neni, vihen në dispozicion të paktën në gjuhën shqipe dhe, nëse është rënë dakord shprehimisht ndërmjet palëve, edhe në një gjuhë tjetër.

4. Ofruesit e shërbimeve të pagesave u përgjigjen ankesave me shkrim ose, nëse është rënë dakord ndërmjet palëve, me një mjet tjetër të qëndrueshëm komunikimi.
5. Përgjigjja e ofruesit të shërbimeve të pagesave sipas pikës 4, të këtij neni, adreson të gjitha çështjet e ngritura brenda një afati të përshtatshëm kohor dhe jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pune pas pranimit të ankesës. Në situata të jashtëzakonshme, nëse përgjigjja nuk mund të jepet brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve punë për arsye jashtë kontrollit të ofruesit të shërbimeve të pagesave, ai njofton me shkrim për arsyet e vonesës së përgjigjes, si dhe përcakton afatin në të cilin përdoruesi i shërbimeve të pagesave do të marrë përgjigjen përfundimtare. Në çdo rast, afati i fundit për marrjen e përgjigjes përfundimtare nuk i kalon 35 (tridhjetë e pesë) ditë pune.
6. Ofruesi i shërbimeve të pagesave informon përdoruesit e shërbimeve të pagesave për të drejtën për të paraqitur ankim pranë njësisë ZAM lidhur me të drejtat e detyrimet që rrjedhin nga titujt III e IV, të këtij ligji.
7. Informacioni sipas pikës 6, të këtij neni, paraqitet në mënyrë të qartë, gjithëpërfshirëse dhe lehtësisht të aksesueshme në faqen e internetit të ofruesit të shërbimeve të pagesave, kur ekziston një e tillë, në degë, si dhe në kontratën tip ndërmjet ofruesit të shërbimeve të pagesave dhe përdoruesit të shërbimeve të pagesave. Ofruesi i shërbimeve të pagesave specifikon se si mund të aksesohen informacione të mëtejshme për procedurat e zgjidhjes alternative të mosmarrëveshjeve.

TITULLI V

KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE, SANKSIONET DHE ANKIMET

KREU I

KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE DHE SANKSIONET

Neni 94

Kundërvajtjet administrative dhe sanksionet

1. Shkeljet e dispozitave të këtij ligji klasifikohen si kundërvajtje administrative dhe Banka e Shqipërisë ka të drejtë të vendosë gjoba ndaj ofruesit të shërbimeve të pagesës ose kundrejt atyre që efektivisht kontrollojnë e administrojnë veprimtarinë e tij.
2. Banka e Shqipërisë vendos gjobë nga 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë deri në 250 000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë për institucionin e pagesave dhe

ofruesin e shërbimeve të pagesave, që përfiton nga përjashtimi sipas neneve 27 ose 28, të këtij ligji, kur kryen shkeljet e mëposhtme:

- a) ofron shërbime të pagesave të papërfshira në licencë ose të paregjistruara sipas neneve 6 e 16, të këtij ligji;
 - b) nuk plotëson kërkesat për kapitalin minimal, siç parashikohet në këtë ligj dhe në aktet nënligjore në zbatim të tij;
 - c) nuk mbron fondet e përdoruesve të shërbimeve të pagesave, në kundërshtim me nenin 12, të këtij ligji;
 - ç) nuk ka krijuar rregulla, procedura dhe sisteme të përshtatshme dhe gjithëpërfshirëse për drejtimin e kontrollin e brendshëm, siç parashikohet në pikën 4, të nenit 13, të këtij ligji;
 - d) nuk njofton Bankën e Shqipërisë për faktet ose rrethanat e reja të konstatuara pas dhënies së licencës, në kundërshtim me nenin 17, të këtij ligji;
 - dh) nuk mban llogaritë kontabël e nuk përgatit raportet financiare për pasqyrimin e gjendjes financiare, në mënyrë të saktë dhe në përputhje me rregullat e parimet kontabël, siç parashikohet në nenin 18, të këtij ligji;
 - e) në rastet kur institucioni i pagesave kryen edhe veprimtari të tjera të ndryshme nga ato të shërbimeve të pagesave, nuk mban informacion të veçantë kontabël, siç parashikohet në pikën 4, të nenit 18, të këtij ligji;
 - ë) nuk raporton sipas formës, tipit, metodologjisë, përmbajtjes dhe afateve të përcaktuara në aktet nënligjore të Bankës së Shqipërisë, siç parashikohet në nenin 18, të këtij ligji;
 - f) jep kredi lidhur me shërbimet e pagesave, në kundërshtim me kërkesat e parashikuara në pikën 4, të nenit 19, të këtij ligji;
 - g) ofron shërbimin e pagesave nëpërmjet agjentëve, pa njoftuar Bankën e Shqipërisë, siç parashikohet në pikën 1, të nenit 21, të këtij ligji;
 - gj) nuk informon Bankën e Shqipërisë për transferimin e funksioneve operacionale të shërbimit të pagesave te të tretët, siç parashikohet në pikën 6, të nenit 21, të këtij ligji.
3. Banka e Shqipërisë vendos gjobë nga 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë deri në 250 000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë për ofruesin e shërbimeve të pagesave, kur kryen shkeljet e mëposhtme:
- a) tarifon përdoruesin e shërbimeve të pagesave për dhënien e informacionit, në kundërshtim me nenin 33, të këtij ligji;
 - b) nuk i siguron përdoruesit të shërbimeve të pagesave informacionin për karakteristikat e shërbimeve të pagesave për instrumentet e pagesave me vlerë të vogël të kryera sipas kontratës tip, të parashikuar në nenin 35, të këtij ligji;
 - c) nuk i siguron përdoruesit të shërbimeve të pagesave informacionin e përgjithshëm për transaksionet individuale të pagesës, të parashikuar në

nenet 37 deri 42, të këtij ligji, ose nuk e siguron informacionin, sipas mënyrës së përcaktuar në këto nene;

- ç) nuk i siguron përdoruesit të shërbimeve të pagesave informacionin e përgjithshëm për transaksionet e pagesave të kryera sipas kontratës tip, të parashikuar në nenet 44 deri 47, të këtij ligji, ose nuk e siguron informacionin sipas mënyrës së përcaktuar në këto nene;
- d) tarifon përdoruesin e shërbimeve të pagesave në rastin e zgjidhjes së kontratës tip, në kundërshtim me nenin 48, të këtij ligji;
- dh) nuk i siguron pagesit informacionin për transaksionin individual të pagesës të parashikuar në nenin 50, të këtij ligji, ose nuk i siguron përfituesit të pagesës informacionin për transaksionin individual të pagesës, të parashikuar në nenin 51, të këtij ligji;
- e) nuk i siguron pagesit informacionin për tarifat e kursin e këmbimit, të parashikuar në nenin 52, të këtij ligji;
- ë) nuk informon përdoruesin e shërbimeve të pagesave përpara iniciimit të transaksionit të pagesës për tarifën e përdorimit të një instrumenti pagese, në kundërshtim me pikën 2, të nenit 53, të këtij ligji;
- f) nuk ekzekuton transaksionin e pagesës pas marrjes së urdhërpagesës, në kundërshtim me nenin 71, të këtij ligji;
- g) nuk informon përdoruesin e shërbimeve të pagesave për refuzimin e ekzekutimit të urdhërpagesës, sipas parashikimeve në pikat 1 dhe 2, të nenit 72, të këtij ligji;
- gj) nuk lejon përdoruesin e shërbimeve të pagesave të revokojë urdhërpagesën, siç parashikohet në nenin 73, të këtij ligji;
- h) nuk transferon shumën e plotë të transaksionit të pagesës, siç parashikohet në pikën 1, të nenit 74, të këtij ligji, ose në rastet kur palët kanë rënë dakord për zbritjen e tarifave nga shuma e transferuar, nuk informon përfituesin për shumën e plotë të transaksionit të pagesës dhe tarifat e zbritura, siç parashikohet në pikën 2, të nenit 74, të këtij ligji;
- i) nuk ekzekuton transaksionin e pagesës brenda afateve kohore të parashikuara në nenin 76, të këtij ligji;
- j) nuk transmeton urdhërpagesën e iniciuar nga ose nëpërmjet përfituesit të pagesës tek ofruesi i shërbimeve të pagesave të pagesit, brenda afateve kohore të rëna dakord ndërmjet palëve, në mënyrë që transaksioni i pagesës të ekzekutohet në ditën e caktuar, siç parashikohet në pikën 3, të nenit 76, të këtij ligji;
- k) nuk vendos fondet në dispozicion të përfituesit të pagesës brenda afateve kohore të përcaktuara në nenet 77 deri në 79, të këtij ligji;
- l) nuk rimbursen shumën e transaksionit të pagesës së paekzekutuar ose të ekzekutuar në mënyrë të gabuar, si dhe tarifat ose interesat përkatëse, siç parashikohen në nenin 82, të këtij ligji;
- ll) nuk respekton kërkesat për ruajtjen e konfidencialitetit të të dhënave, në kundërshtim me përcaktimet e këtij ligji;

- m) nuk përcakton procedurat ose rregullat për zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve lidhur me ofrimin e shërbimeve të pagesave ose nëse këto procedura ose rregulla nuk përmbushin kërkesat e parashikuara në këtë ligj.
4. Banka e Shqipërisë vendos gjobë nga 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë deri në 250 000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë, kur konstaton shkeljet e mëposhtme:
- a) për pjesëmarrësin në një sistem pagesash, në rast se vepron në kundërshtim me parashikimet e pikës 3, të nenit 29, të këtij ligji;
 - b) për bankën, në rast se vepron në kundërshtim me parashikimet e nenit 30, të këtij ligji.
5. Banka e Shqipërisë vendos gjobë nga 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë deri në 250 000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë, kur ofruesi i shërbimit të pagesës për shërbimin e llogarisë kryen shkeljet e mëposhtme:
- a) kur nuk i konfirmon menjëherë ofruesit të shërbimeve të pagesave nëse shuma e nevojshme për ekzekutimin e transaksionit të pagesës me kartë (*card-based*) është e disponueshme në llogarinë e pagesës së paguesit, siç parashikohet në nenin 58, të këtij ligji;
 - b) nuk ofron informacionin e nevojshëm për realizimin e një transaksioni që iniciohet nëpërmjet një ofruesi për shërbimin e iniciimit të pagesës, në kundërshtim me parashikimet e nenit 59, të këtij ligji;
 - c) nuk ofron informacionin e nevojshëm për ofruesin e shërbimit për informimin e llogarisë, në kundërshtim me parashikimet e nenit 60, të këtij ligji.
6. Banka e Shqipërisë vendos gjobë nga 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë deri në 250 000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë për ofruesin e shërbimeve të pagesave që përfiton nga përjashtimi sipas neneve 27 ose 28, të këtij ligji, nëse nuk njofton Bankën e Shqipërisë për çdo ndryshim të situatës së tij, që ndikon në përmbushjen e kushteve për të përfituar nga përjashtimi.
7. Banka e Shqipërisë vendos gjobë nga 10 000 (dhjetë mijë) lekë deri në 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë për punonjësit përgjegjës për shkeljet e parashikuara në pikat 2 dhe 3, të këtij neni.
8. Banka e Shqipërisë vendos gjobë nga 20 000 (njëzet mijë) lekë deri në 100 000 (njëqind mijë) lekë për administratorin e institucionit të pagesave ose për personin përgjegjës për drejtimin, lidhur me shërbimet e pagesave, në rast se nuk i paraqet Bankës së Shqipërisë informacionin e nevojshëm,

sipas formës dhe afatit kohor të kërkuar, siç parashikohet në pikën 2, të nenin 25, të këtij ligji.

9. Banka e Shqipërisë vendos gjobë nga 5 000 (pesë mijë) lekë deri në 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë për punonjësin përgjegjës për shkeljen e parashikuar në pikën 8, të këtij neni.
10. Banka e Shqipërisë, përveç rasteve të shfuqizimit të licencës sipas pikës 1, të nenit 15, dhe pezullimit të një ose disa veprimtarive sipas shkronjës “c”, të pikës 2, të nenit 25, të këtij ligji, kur e gjykon të arsyeshme, mund të pezullojë një ose disa veprimtari apo të shfuqizojë licencën e institucionit të pagesës, në rastet kur kërkohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave sipas legjislacionit në fuqi për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.
11. Në përcaktimin e masës së gjobës sipas pikave 2 deri në 9, të këtij neni, Banka e Shqipërisë mban në konsideratë:
 - a) rrethanat nën të cilat është kryer shkelja;
 - b) pasojat e shkeljes;
 - c) përsëritjen e shkeljes;
 - ç) rëndësinë dhe kohëzgjatjen e shkeljes.
12. E drejta për shqyrtimin e kundërvajtjeve administrative të parashikuara në këtë nen nuk mund të ushtrohet kur kanë kaluar 3 (tre) vjet nga çasti i kryerjes së kundërvajtjes administrative.
13. Në rastin e përsëritjes së shkeljeve ose në rast se gjoba nuk paguhet brenda afatit dhe sipas procedurës së përcaktuar në legjislacionin “Për kundërvajtjet administrative”, Banka e Shqipërisë vendos dyfishimin e gjobës.

Në rast se shkeljet përsëriten dhe gjoba sërish nuk paguhet brenda afatit, atëherë Banka e Shqipërisë vendos të pezullojë ushtrimin e një ose disa veprimtarive për një periudhë 6- (gjashtë-) mujore. Në vendimin për pezullimin e ushtrimit të një ose disa veprimtarive, Banka e Shqipërisë ngarkon subjektin/personin me pagimin e të gjitha detyrimeve të prapambetura dhe me plotësimin e të gjitha të metave të konstatuara. Në rast se pas plotësimit të afatit 6- (gjashtë-) mujor të pezullimit, Banka e Shqipërisë vlerëson se subjekti nuk i ka plotësuar të gjitha detyrimet e parashikuara më sipër në këtë pikë, atëherë ajo vendos për shfuqizimin e licencës.
14. Gjobat e vendosura sipas këtij neni arkëtohen për llogari të Bankës së Shqipërisë.

15. Gjambat janë tituj ekzekutivë dhe me ekzekutimin e tyre ngarkohet Zyra e Përmbarimit.

Neni 95

Publikimi i sanksioneve

1. Banka e Shqipërisë publikon në faqen zyrtare të internetit sanksionet e vendosura për shkelje të dispozitave të këtij ligji. Publikimi bëhet menjëherë pasi personi, ndaj të cilit është vendosur sanksioni, të jetë informuar për atë sanksion, duke përfshirë informacione për llojin e natyrën e shkeljes dhe identitetin e individit apo e personit juridik mbi të cilin është vendosur sanksioni.
2. Në rastin e publikimit të sanksioneve, kundër të cilave është bërë ankesë, Banka e Shqipërisë publikon informacionin për statusin e ankesës dhe rezultatin e saj.
3. Publikimi, në përputhje me këtë nen, qëndron në faqen zyrtare të internetit të Bankës së Shqipërisë maksimumi një vit dhe, në çdo rast, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.
4. Banka e Shqipërisë nuk publikon sanksionet vetëm në rast se në gjykimin e saj publikimi rrezikon seriozisht stabilitetin e tregjeve financiare ose u shkakton dëm joproporcional palëve të përfshira.

KREU II

ANKIMI ADMINISTRATIV E GJYQËSOR

Neni 96

Ankimi administrativ

1. Çdo institucion pagese, i cili pretendon se të drejtat dhe interesat e ligjshme të tij janë cenuar nga akte administrative të nxjerra në zbatim të dispozitave të këtij ligji, ka të drejtë të kryejë ankim administrativ te Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijeni e aktit.
2. Realizimi i ankimit administrativ, sipas këtij neni, është kusht paraprak për kundërshtimin e aktit në gjykatë.
3. Ankimi administrativ nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ të nxjerrë nga Banka e Shqipërisë.
4. Ankimi administrativ paraqitet në formën e parashikuar në Kodin e Procedurave Administrative dhe shqyrtohet brenda afateve të përcaktuara në këtë kod.

Neni 97
Ankimi gjyqësor

1. Çdo institucion pagese ka të drejtë të paraqesë ankim gjyqësor në Gjykatën Administrative të Apelit në përfundim të procesit të ankimit administrativ kundrejt aktit të nxjerrë nga Banka e Shqipërisë.
2. Pika 1 e këtij neni, zbatohet edhe në rast mungese të nxjerrjes së një akti nga ana e Bankës së Shqipërisë.

TITULLI VI
DISPOZITA TË FUNDIT DHE KALIMTARE

Neni 98
Rishikimi i ligjit

Banka e Shqipërisë konsulton e konsultohet nga të tretët lidhur me rishikimin e këtij ligji dhe me iniciativat e tjera legjislative brenda fushëveprimit të këtij ligji ose që në ndonjë mënyrë mund të ndikojnë në dispozitat e këtij ligji.

Neni 99
Dispozitë kalimtare

1. Bankat e licencuara nga Banka e Shqipërisë, para hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe që ushtrojnë veprimtarinë financiare të shërbimeve të pagesave dhe të transferimit të parave, konsiderohen të licencuara për ushtrimin e veprimtarisë së shërbimeve të pagesave, sipas aneksit 1, të këtij ligji. Banka e Shqipërisë pajis bankat me aneksin e përditësuar të licencës.
2. Institucionet e parasë elektronike, subjektet financiare jo banka dhe shoqëritë e kursim-kreditit të licencuara nga Banka e Shqipërisë, para hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe që ushtrojnë veprimtarinë financiare të shërbimeve të pagesave dhe të transferimit të parave, vlerësohen nga Banka e Shqipërisë të licencuara për ushtrimin e veprimtarisë së shërbimeve përkatëse të pagesave, sipas aneksit 1, të këtij ligji, në varësi të modelit të biznesit që aplikon secili subjekt.
3. Subjektet e përmendura në pikat 1 dhe 2, të këtij neni, duhet të marrin masa për organizimin e veprimtarisë dhe të strukturës së brendshme, në përputhje me kërkesat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, brenda 18 (tetëmbëdhjetë) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.
4. Subjektet financiare jo banka dhe shoqëritë e kursim-kreditit, të licencuara nga Banka e Shqipërisë para hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe që ushtrojnë

veprimtarinë financiare të shërbimeve të pagesave dhe të transferimit të parave, paraqesin në Bankën e Shqipërisë, brenda 18 (tetëmbëdhjetë) muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, dokumentacionin dhe informacionin e mëposhtëm për plotësimin e kërkesave të këtij ligji:

- a) përshkrimi i shërbimeve të pagesave, sipas aneksit 1, të këtij ligji, që kryhen nga subjekti dhe do të vijojnë të kryhen pas hyrjes në fuqi të këtij ligji;
 - b) përshkrim të masave të marra për mbrojtjen e fondeve të përdoruesve të shërbimeve të pagesave, në përputhje me pikën 1, të nenit 12, të këtij ligji;
 - c) strukturë organizative me përshkrime të sakta, të specifikuara, transparente e të qëndrueshme të përgjegjësive, në përputhje me shkronjën “d”, të pikës 1, të nenit 7, të këtij ligji;
 - ç) listë e agjentëve, si dhe të marrëveshjeve për transferimin e funksioneve operacionale të të tretët dhe evidencë që ata plotësojnë kushtet sipas nenit 21, të këtij ligji;
 - d) përshkrim të pjesëmarrjes së subjektit në një sistem pagesash, nëse është e aplikueshme;
 - dh) të dhëna për aksionarët/ortakët me pjesëmarrje influencuese në kapital, në përputhje me shkronjën “i”, të pikës 1, të nenit 7, të këtij ligji;
 - e) të dhëna për administratorin dhe personat përgjegjës për administrimin e veprimtarisë së shërbimeve të pagesave, në përputhje me shkronjën “j”, të pikës 1, të nenit 7, të këtij ligji.
5. Subjektet financiare jo banka dhe shoqëritë e kursim-kreditit të licencuara nga Banka e Shqipërisë para hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe që ushtrojnë veprimtarinë financiare të shërbimeve të pagesave dhe të transferimit të parave, pas plotësimit të kërkesave të pikave 3 e 4, të këtij neni, pajisen me aneksin e përditësuar të licencës dhe konsiderohen “institucion pagese”.
6. Institucionet e parasë elektronike të licencuara nga Banka e Shqipërisë para hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe që ushtrojnë veprimtarinë financiare të shërbimeve të pagesave e të transferimit të parave, pas plotësimit të kërkesave të pikave 3 dhe 4, të këtij neni, pajisen me aneksin e përditësuar të licencës për shërbimet e pagesave që ushtrojnë.
7. Banka e Shqipërisë, pasi pajis subjektet financiare jo banka dhe shoqëritë e kursim-kreditit me licencën dhe aneksin e përditësuar, i regjistron ato në regjistrin publik të institucioneve të pagesave si një institucion pagese, në përputhje me nenin 16, të këtij ligji.
8. Banka e Shqipërisë urdhëron ndërprerjen e veprimtarisë së shërbimeve të pagesave dhe transferimit të parave për subjektet e përmendura në pikën 2, të

këtij neni, në rast se brenda 18 (tetëmbëdhjetë) muajve nuk përmbushin kërkesat e këtij ligji.

9. Kërkesat për marrjen e licencës për të ushtruar veprimtarinë e shërbimeve të pagesave dhe të transferimit të parave, të cilat janë duke u shqyrtuar nga Banka e Shqipërisë, në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të trajtohen në përputhje me kërkesat e këtij ligji.

Neni 100 **Aktet në zbatim të ligjit**

Ngarkohet Banka e Shqipërisë me nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të këtij ligji brenda 1 viti nga hyrja në fuqi e tij.

Neni 101 **Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 6 muaj pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

K R Y E T A R

GRAMOZ RUÇI

ANEKSI 1

SHËRBIMET E PAGESAVE

(sipas përkufizimit të pikës 37, të nenit 5, të këtij ligji)

1. Shërbimet që mundësojnë depozitimin e parave fizike në një llogari pagese, si dhe të gjitha veprimet e nevojshme për funksionimin e një llogarie pagese.
2. Shërbimet që mundësojnë tërheqjen e parave fizike nga një llogari pagese, si dhe të gjitha veprimet e nevojshme për funksionimin e një llogarie pagese.
3. Ekzekutimi i transaksioneve të pagesave, duke përfshirë transferimet e fondeve në një llogari pagesash të çelur pranë ofruesit të shërbimit të pagesave të përdoruesit ose pranë një ofruesi tjetër të shërbimit të pagesave:
 - a) ekzekutimi i debitimeve direkte, duke përfshirë dhe debitimet direkte që bëhen vetëm një herë;
 - b) ekzekutimi i transaksioneve të pagesave përmes një karte pagese ose nga një pajisje e ngjashme;
 - c) ekzekutimi i transfertave të kreditit, duke përfshirë urdhërpagesat periodike.
4. Ekzekutimi i transaksioneve të pagesave, ku fondet janë të mbuluara nga një linjë kredie për një përdorues të shërbimit të pagesave:
 - a) ekzekutimi i debitimeve direkte, duke përfshirë debitimet direkte që bëhen vetëm një herë;
 - b) ekzekutimi i transaksioneve të pagesave përmes një kartë pagese ose nga një pajisje e ngjashme;
 - c) ekzekutimi i transfertave të kreditit, duke përfshirë pagesat periodike.
5. Emetimi i një instrumenti pagese dhe/ose pranimi i transaksioneve të pagesave.
6. Dërgesat e parave.
7. Shërbimi i iniciimit të pagesës.
8. Shërbimi i informimit të llogarisë.